

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6036
E shtunë, 13 qershor 2020
çmimi 0.40 €

Kryeministri Hoti vlerëson rolin e pazëvendësueshëm të shteteve të Quint-it

FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

REPUBLIKA E KOSOVËS SHËNOI PËRVJETORIN E LIRISË

FAQE 4-5

EDHE 21 VJET PAS ÇLIRIMIT,

KOSOVËN E PRESIN SFIDA



Kosova ka kremtuar të premten Ditën e Çlirimit. Për nder të 21-vjetorit të çlirimit dhe hyrjes ushtarake të NATO-s, populli i Kosovës ka marrë urime të shumta nga aleatë që e kanë

ndihmuar në kohët më të vështira. Me këtë rast, liderët institucionalë kanë falënderuar NATO-n dhe ShBA-në për ndihmën e dhënë, duke thënë se Dita e Çlirimit u arrit edhe falë luftës dhe

sakrificës së pashembullt të popullit të Kosovës. 21 vjet pas çlirimit, Kosovën e presin shumë sfida si në planin e brendshëm, po ashtu edhe në atë të jashtëm

KURTI: DUAM SHTET QË PUNON PËR QYTETARIN

FAQE 3

Në tubimin e organizuar për nder të 21-vjetorit të çlirimit të Kosovës dhe 15-vjetorit të themelimit të Lëvizjes Vetëvendosje, ish-kryeministri dhe lideri i këtij subjekti politik, Albin Kurti, ka thënë se qeverisja e tij e mirë u ndërpre sepse, sipas tij, ata që e kanë

kapur shtetin nga të gjitha anët, u kapën së bashku. Kurti ka bërë me dije se sfida e LV-së dhe e tij si lider është çlirimi i Kosovës nga korrupsioni dhe kapësit e shtetit. "Duam shtet që punon për qytetarin. Më 6 tetor kanë ndryshuar politika e



qeveria. Nuk do të kthehemi kurrë para 6 tetorit, në politikën e vjetër të gënjeshtreve", ka thënë Kurti

PREKAZI DHE ADEMI

F. 11

Bedri ISLAMI



OPINION

12 QERSHORI - DITA E ÇLIRIMTARËVE TË KOSOVËS

Lulëzim ETEMAJ



AKTUALE



20 VENTILATORË MOBILË IU DORËZUAN QKUK-së

F. 6

EKONOMI

BORDI I PËRKOHSHËM I "TREPÇËS" NUK E PRANON VENDIMIN E INSPEKTORATIT PËR BASRI IBRAHIMIN

F. 9

BANKA BOTËRORE PËRKRAH PROJEKTET BUJQËSORE

F. 9

SPORT



SOT RIFILLOJNË GARAT NË HENDBOLL

F. 18

KOSOVA DO TË KETË OFICERË NDËRLIDHËS NË EUROPOL

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Kosova do të ketë oficerë ndërlidhës në Europol

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Bordi drejtues i Agjencisë së Inteligjencës së Bashkimit Evropian, Europol, miratoi marrëveshjen e punës me agjencitë e zbatimit të ligjit në Kosovë, njoftoi të premten Ministria e Brendshme e Kroacisë - vendit që aktualisht kryeson Këshillin e BE-së.

Vendimi u mor në seancën e 115-të të këtij bordi që u mbajt në format të video-konferencës më 9 dhe 10 qershor. Bëhet me dije se marrëveshja do të nënshkruhet nga drejtorja ekzekutive e Europol-it dhe ministri i Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike të Kosovës.

Marrëveshja, e miratuar nga bordi drejtues, parashikon bashkëpunim midis Europol-it dhe Policisë së Kosovës, Doganave të Kosovës, Administratës Tatimore dhe njësive për parandalimin e pastrimit të parave. Sipas njoftimit, me këtë marrëveshje Kosovës "i jepen mundësi të reja në bashkëpunimin ndërkombëtar policor".

Kosova deri më tani ka qenë vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor me të cilin Europol-i nuk ka pasur marrëveshje bashkëpunimi dhe rrjedhimisht nuk ka pasur mundësi të shkëmbimit të informacioneve me qëllim luftimin e krimit të rëndë dhe të organizuar.

Bazuar në këtë marrëveshje pune, e cila do të hyjë në fuqi në ditën e nënshkrimit, Kosova do të krijojë një zyrë qendrore për bashkëpunim me Europolin dhe do ta fitojë qasjen në kanalim e komunikimit të Europolit si dhe mundësinë e dërgimit të oficerëve ndërlidhës në selinë e Europolit në Hagë.

Përveç bashkëpunimit me Europolin, "Kosova në këtë mënyrë do të ketë edhe një formë të re dhe më aktive të bashkëpunimit me të gjitha vendet e BE-së", thuhet në deklaratë.

Shqipëria, Mali i Zi, Serbia dhe Maqedonia e Veriut janë në mesin e vendeve që nuk janë anëtare të BE-së, por që kanë



oficerë ndërlidhës në Europol. Ministria e Brendshme kroate tha se marrëveshja me Kosovën "është një hap i rëndësishëm në forcimin e bashkëpunimit me partnerët në Evropën Juglindore, në përgjigje të sfidave të sigurisë dhe promovimit të vlerave evropiane".

Kosova qysh në vitin 2010 ka bërë disa përpjekje për t'u anëtarësuar edhe në agjencinë ndërkombëtare të policisë, Interpol, por është penguar nga Serbia e cila ka bërë fushatë kundër Kosovës.

Herën e fundit, në nëntor të vitit 2018, ajo nuk ka arritur ta sigurojë shumicën e nevojshme,

prej dy të tretave të votave të vendeve pjesëmarrëse në Asambleenë e Përgjithshme të Interpolit, për t'u bërë anëtare e këtij mekanizmi.

Në tetor të vitit të kaluar Qeveria e atëhershme e Kosovës e ka tërhequr kërkesën për anëtarësim, duke e shtyrë për këtë vit.

Në 24 orët e fundit edhe dy të vdekur nga Covid-19 në Maqedoni

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Ministria e Shëndetësisë e Maqedonisë së Veriut edhe të premten ka regjistruar shifra të larta të të infektuarve me Covid-19.

Ministri i Shëndetësisë, Venko Filipçe, ka njoftuar për 164 të infektuar dhe dy të vdekur nga koronavirusi në 24 orët e fundit.

Viktimit janë nga Shkupi dhe Tetova, të moshës 53 dhe 60 vjeç, të cilët vuanin edhe nga sëmundje të tjera kronike, si sëmundje të zemrës, diabeti



dhe tensioni i lartë. Me shifrat e fundit, numri i përgjithshëm i të vdekurve nga Covid-19 ka

arritur në 171 persona, prej tyre vetëm në Shkup janë regjistruar 47 viktima dhe nga 27 në

Kumanovë dhe Tetovë.

Sa iu përket të infektuarve, nga 164 rastet vetëm në Shkup janë regjistruar 85 raste, 24 në Kumanovë, 18 në Tetovë, ndërsa në 14 qytete të tjera numri është më u ulët se dhjetë raste. Për herë të parë pas gati dy muajve, tre raste janë regjistruar në qytetin e Dibrës, qytet ku u regjistruan rastet e para me koronavirus në Maqedoninë e Veriut.

Gjendja e të infektuarve është stabile, sipas drejtuesve të Klinikës Infektive në Shkup. Në

këtë spital aktualisht po trajtohen më shumë se 90 persona. Sipas të dhënave të Ministrisë së Shëndetësisë, numri i personave të infektuar është për rreth 200 më i lartë se i të shëruarve. Prej 3 701 personave që kanë rezultuar pozitivë me Covid-19, tani raste aktive janë 1 836, ndërsa janë shëruar 1 694 persona. Të dhënat i referohen testimit të 1 045 mostrave, ndërsa numri i përgjithshëm i testeve të bëra në Maqedoninë e Veriut ka arritur në mbi 41 000.

Tërhiqet Greqia, shtyn edhe për me dy javë hapjen e kufijve me Shqipërinë

TIRANË, 12 QERSHOR - Shqipëria dhe Greqia ranë dakord dy ditë më parë për hapjen e kufijve ajrorë dhe për nisjen e fluturimeve mes Athinës dhe Tiranës më 15 qershor. Dhe pikërisht atëherë kur shumë vende kanë nisur planet e lëvizjes, ministri grek i Turizmit ka dhënë një tjetër lajm. Sipas tij, fluturimet ajrore do të jenë vetëm për ata që kanë

leje qëndrimi dhe çështje pune, por jo për turistë. E njëjta gjë është vendosur edhe për pikat tokësore dhe detare. Nuk do të lejohen kalimet e mjeteve për qëllime turistike, por vetëm ato me autorizim të posaçëm, ose për çështje pune.

E vetmja klauzolë, që e bën deri-diku të pranueshëm këtë vendim, është leja për të kaluar në tokën greke shqip-

tarët që kanë dokumente të përhershme në shtetin grek. Ndërkohë, autoritetet doganore e kanë marrë tashmë vendimin e ministrisë dhe janë njoftuar përmes rrugëve zyrtare të gjitha pikat e ndërlidhjes.

I njëjti vendim është marrë edhe për Maqedoninë Veriore, me të cilën do të ketë vetëm fluturime për çështje pune, por jo turizmi.



Kurti: Duam shtet që punon për qytetarin

Në tubimin e organizuar për nder të 21-vjetorit të çlirimit të Kosovës dhe 15-vjetorit të themelimit të Lëvizjes Vetëvendosje, ish-kryeministri dhe lideri i këtij subjekti politik, Albin Kurti, ka thënë se qeverisja e tij e mirë u ndërpre sepse, sipas tij, ata që e kanë kapur shtetin nga të gjitha anët, u kapën së bashku. Kurti ka bërë me dije se sfida e LV-së dhe e tij si lider është çlirimi i Kosovës nga korrupsioni dhe kapësit e shtetit. “Duam shtet që punon për qytetarin. Më 6 tetor ka ndryshuar politika e qeveria. Nuk do të kthehemi kurrë para 6 tetorit, në politikën e vjetër të gënjeshtreve”, ka thënë Kurti



për shtet të pavarur e sovran, që nuk negocion me Serbinë për çështjet e brendshme. Ishim gjithmonë për një shtet që vetëvendos për qytetarët e vet. Për 15 vjet kemi pasur shumë pengesa e sfida, kemi marshuar qindra herë për atë që besojmë se është e drejtë e dimë që është e vërtetë. Kanë rrahur e lënduar mijëra prej nesh, kanë burgosur e maltretuar qindra prej nesh, e kanë vranë disa prej nesh, në mesin e tyre Astrit Deharit që e vranë në burg, po ashtu, Monin e Arbenin”, ka deklaruar Kurti.

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Lëvizja Vetëvendosje ka mbajtur të premtën në sheshin “Skënderbeu” një tubim për nder të 21-vjetorit të çlirimit të Kosovës dhe 15-vjetorit të themelimit të këtij subjekti politik. Në këtë tubim kanë folur përfaqësues të LV-së, të cilët kanë vlerësuar se kjo lëvizje çdo

ditë e më shumë po merr përkrahje të popullit. Ish-kryeministri dhe lideri i LV-së, Albin Kurti, në fjalimin e tij ka falënderuar qytetarët të cilët kishin ardhur në këtë tubim. “Dua të filloj me një falënderim për secilin prej jush që keni ardhur këtu për këtë ngjarje, por edhe ata që na ndjekin përmes ekraneve, po ashtu edhe diasporën. Para 21 vjetësh, këmbësoria e NATO-s hyri në

Kosovë, duke shënuar fundin e luftës dhe çlirimin e Kosovës. Sot kujtojmë dhe festojmë këtë liri që e fituam me gjakun e ushtarëve tanë, me luftën e UÇK-së dhe me sakrificën e gjeneratave të tëra. Sot e kujtojmë edhe gjenocidin, vrasjen e mbi 13 mijë civilëve, zhdukjen po ashtu, përdhunimet masakra e dëbimin e masiv, djegiet dhe gjymtimin e ekonomisë e infrastrukturës. Sot i jemi falënderues NATO-s”, ka thënë Kurti para të pranishmëve.

Ai ka thënë se qeverisja e tij e mirë u ndërpre “sepse ata që e kanë kapur shtetin nga të gjitha anët, u kapën së bashku”. “Më 6 tetor e 3 shkurt, ne e çliruam politikën, por e patë se si reagan regjimi i vjetër dhe kapësit e shtetit. E patë se si presidenti i zgjedhur me vota të kontrabanduara në Kuvend u vërsul për ta rrëzuar qeverinë.

Në LV ai nuk ka bashkëpunëtorë, por gjeti në LDK, e cila braktisi qeverisjen e mirë dhe tash janë të gjithë së bashku në një qeveri koti dhe që për kumbar e kanë presidentin. Dhe mirë që janë bashkë, pasi që 20 vjet janë bashkë në vjedhje e zhvatje”, ka thënë Kurti, i cili ka përmendur që edhe sot, pas 21 vjetëve, qëllimi është të krijohet një qeveri e drejtë, pa korrupsion. “Sfida jonë 21 vjet pas çlirimit nga Serbia është çlirimi i Kosovës nga korrupsioni dhe kapësit e shtetit. Kjo sfidë na takon neve qytetarëve të bashkuar, duke zgjedhur përfaqësuesit tanë të ndershëm”, ka thënë Kurti.

Ish-kryeministri Albin Kurti para turmës së mbledhur në sheshin “Skënderbeu” ka folur edhe për 15-vjetorin e themelimit të Vetëvendosjes. “Jo negociata, Vetëvendosje, ishte parulla e kërkesës sonë të qartë politike

Kurti ka shtuar se kanë bërë gjithnjë rezistencë brenda e jashtë institucioneve të Kosovës. “Në opozitë kemi marshuar e protestuar kundër padrejtësive, por edhe kemi adresuar probleme e korrupsionit, shtetit të kapur e varfërisë. Jemi bashkë edhe për një president që do të na përfaqësojë të gjithëve. Disa familje kanë kapur të gjitha institucionet. Duam shtet që punon për qytetarin. Më 6 tetor kanë ndryshuar politika e qeveria. Nuk do të kthehemi kurrë para 6 tetorit, në politikën e vjetër të gënjeshtreve. Nuk kthehemi para 6 tetorit sepse kemi parë se qeverisja e mirë është e mundur, luftimi i korrupsionit është i mundur, bordet politike mund të jenë pa familjarë, kemi parë se Kosova mund të bëhet shtet normal e që punon për të gjithë, kemi parë që ndryshimi është i mundur”, ka thënë Kurti.



Heldt e Apostolova, të zhgënjyer për mosratifikimin e marrëveshjeve ndërkombëtare nga Kuvendi

EPOKA
ERE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Mosmiratimi i projektligjeve për ratifikimin e pesë marrëveshjeve ndërkombëtare, për të cilat kanë arritur pajtueshmëri autoritetet e Kosovës, ka nxitur reagimin e ambasadorit të Gjermanisë në Prishtinë, Christian Heldt.

Kuvendi i Kosovës, në seancën e mbajtur më 11 qershor, ka dështuar të miratojë një sërë marrëveshesh ndërkombëtare financiare që Qeveria e Kosovës ka nënshkruar me mekanizmat ndërkombëtarë.

Ambasadori i Gjermanisë në Prishtinë, Christian Heldt, ka kritikuar Kuvendin e Kosovës për këtë gjë. “Fjala zhgënjim është shumë diplomatike. A do ta shohim së shpejti Kuvendin e Kosovës duke punuar? Kjo kishte të bënte me paketat e ndihmës për shtetin dhe popullin”, ka shkruar Heldt në një postim në rrjetin social “Twitter”.

Edhe shefja e Zyrës së BE-së në Prishtinë, Nataliya Apostolova,

është shprehur “e zhgënjyer” që Kuvendi nuk ka miratuar këto legjislacione.

Marrëveshjet ndërkombëtare, përfshirë këtu edhe marrjen përsipër të detyrimeve financiare nga ana e Kosovës, sipas Kushtetutës, duhet të ratifikohen në Kuvend me dy të tretat e votave të të gjithë deputetëve. Por, nuk u arrit të sigurohej numri i mjaftueshëm i votave për, prej 2/3 të deputetëve të pranishëm, për miratimin e projektligjeve për ratifikimin e pesë marrëveshjeve ndërkombëtare nga grupet parlamentare në opozitë nuk u dhanë mbështetje atyre.

Sipas të dhënave të Ministrisë së Financave dhe Transfereve, totali i marrëveshjeve të cilat duhen ratifikuar në procedurë të përshtetshme përfshin pesë marrëveshje kredie në vlerë 228.1 milionë eurove dhe dy marrëveshje bashkëfinancimi në vlerë 61 milionë eurove.

Marrëveshjet ndërkombëtare që duhet të miratohen janë: Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për financim mes



Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim për projektin e fuqizimit të sektorit financiar, Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për hua ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Projektin e zhvillimit të ujërave të zeza në Gjilan, Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes për financimin e projektit për

kadastër të patundshmërisë dhe infrastrukturë gjeohapësinore ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Asociacionit Ndërkombëtar për Zhvillim, Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit “Dogana 2020”, si dhe Projektligji për ratifikimin e marrëveshjes

ndërmjet Bashkimit Evropian dhe Republikës së Kosovës mbi pjesëmarrjen e Kosovës në Programin e Bashkimit “Fiskalis 2020”.

Tani i mbetet kryesisë së Kuvendit të vendosë në lidhje me këto marrëveshje sikurse edhe për shqyrtimin e raportit vjetor financiar të buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2019.

REPUBLICA E KOSOVËS SHËNOI PËRVJETORIN E LIRISË

EDHE 21 VJET PAS ÇLIRIMIT,

Kosova ka kremtuar të premtën Ditën e Çlirimit. Për nder të 21-vjetorit të çlirimit dhe hyrjes ushtarake të NATO-s, populli i Kosovës ka marrë urime të shumta nga aleatë që e ndihmuan në kohët më të vështira. Me këtë rast, liderët institucionalë kanë falënderuar NATO-n dhe ShBA-në për ndihmën e dhënë, duke thënë se Dita e Çlirimit u arrit edhe falë luftës dhe sakrificës së pashembullt të popullit të Kosovës. 21 vjet pas çlirimit, Kosovën e presin shumë sfida si në planin e brendshëm, po ashtu edhe në atë të jashtëm

**EPOKA E RE** **Muhamet KOCI**

PRISHTINË 12 QERSHOR - Kosova ka shënuar të premtën 21-vjetorin e lirisë dhe hyrjes ushtarake të NATO-s. Për nder të Ditës së Çlirimit, institucionet e Kosovës kanë organizuar aktivitete të shumta, ndërsa liderët institucionalë kanë vlerësuar se kjo ditë ka ardhur falë sakrificës së madhe të popullit të Kosovës dhe ndihmës së aleatëve të NATO-s.

Presidenti, kryeparlamentarja, kryeministri dhe liderët e tjerë partiakë të Kosovës për këtë ditë kanë falënderuar NATO-n dhe ShBA-në. "Sot u bënë njëzet e një vjet çlirim. Sot Aleanca Veriatlantike i bëri njëzet e një vjet prani në Kosovë. Liria e Kosovës është mbi të gjitha rezultat i luftës dhe sakrificës së pashembullt heroike të burrave e grave të vendit tonë. Në këtë rrugëtim historik, ndihma nga aleatët tanë në NATO është e patjetërsueshme", ka shkruar presidenti Hashim Thaçi në llogarinë e vet në "Facebook".

Ai ka falënderuar NATO-n, ShBA-në dhe partnerët ndërkombëtarë të cilët kanë dhënë kontribut të çmuar për

lirinë e Kosovës. "Lavdi të përjetshme të gjithë të rënëve! Falënderim të përjetshëm NATO-s, ShBA-së dhe gjithë partnerëve ndërkombëtarë. Mirënjohje të pakufishme të gjithë atyre që çdo ditë, me punë e përkushtim, angazhohen për integrimin dhe forcimin e shtetit dhe kombit tonë!", ka shkruar Thaçi.

Kuvendi i Kosovës për nder të kësaj dite ka mbajtur seancë solemne. Me këtë rast, kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, ka thënë se 21 vjet më parë u realizua ëndrra dhe përkushtimi i brezave të tërë që luftuan për liri. Ajo ka propozuar që një ulëse në sallën e Kuvendit t'i kushtohet fëmijëve të vrarë gjatë luftës së fundit. Duke kujtuar ardhjen e Ditës së Çlirimit, Osmani ka thënë se pas 78 ditë bombardimeve shpresa ngadhënjeu, Kosova e pa dritën e lirisë dhe qytetarët morën frymë. "Prandaj ne u çliruam sepse edhe e fituam lirinë e brendshme dhe këmbëngulëm në vlerat humanë kur fqinjët tanë i shkelen atë. Do t'i propozojë Kuvendit që njërin nga ulëset në qendër të sallës ta mbajmë të rezervuar si dedikim të fëmijëve të pafajshëm të këtij vendi të

cilëve iu këput ëndrra për jetë", ka thënë ajo.

Osmani ka thënë se sot duhet unitet për paqe të qëndrueshme dhe mbrojtje të sovranitetit e territorit në Kosovë. "Ne e njohim shumë mirë peshën e lirisë sepse e kemi përjetuar me shekuj të tërë mungesën e saj. Pavarësia e Kosovës e ka vulosur fatin e popujve në Ballkan. Historinë e kemi në krah. Kosova e ka numrin e madh të fëmijëve e grave të vrara. Në këtë ditë të lirisë, kemi një mesazh, siç ishim unikë dikur si një akt sublim, sot të jemi unikë në idenë për paqe të qëndrueshme duke mbrojtur sovranitetin e territorit tonë në çdo pëllëmbë", ka thënë ajo.

Kurse kryeministri Avdullah Hoti ka bërë homazhe te shtatorja e

heroit Zahir Pajaziti. Nga aty, Hoti ka deklaruar se kjo ditë është e veçantë për nga dita e rëndësisë, duke shtuar se duhet të jemi falënderues ndaj partnerëve ndërkombëtarë. "Është ditë e veçantë për popullin e Kosovës, këtë ditë, secili për neve e kemi parasysh entuziazmin dhe emocionin që kanë përjetuar qytetarët e Kosovës në atë ditë kur trupat e NATO-s futeshin në Kosovë. Jemi falënderues për partnerët tanë ndërkombëtarë për lirinë që ne sot e gëzojmë", ka thënë Hoti.

Për Ditën e Çlirimit, popullin e Kosovës e kanë urrear liderët e tjetër politikë. Lideri i LV-së, Albin Kurti, ka deklaruar se liria e Kosovës është rezultat i përpjekjeve të gjeneratave të cilat nuk u dorëzuan kurrë. "Gjithmonë kemi pasur lëvizje për liri, drejtësi dhe përparim. Liria jonë është rezultat i përpjekjeve të gjeneratave të cilat nuk u dorëzuan kurrë. Sot jemi falënderues ndaj qytetarëve tanë dhe aleatëve tanë. Urime Ditën e Çlirimit, Kosovë! Urime 15-vjetorin Lëvizja Vetëvendosje", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Twitter". Këtë ditë e kanë kujtuar edhe lideri i PDK-së, Kadri Veseli, ai i AAK-së, Ramush Haradinaj dhe kreu i Nismës, Fatmir Limaj. Me rastin e Ditës së Çlirimit ish të burgosurit politikë kanë vizituar burgun muze të Prishtinës.

Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë më 12 qershor 1999 pasoi fushatën e sulmeve ajrore të Aleancës Veri-Atlantike kundër caqeve serbe në Kosovë dhe në

Serbi që zgjati 78 ditë.

Futja e NATO-s në Kosovë, më 12 qershor 1999, kishte mundësuar edhe kthimin në shtëpitë e tyre të më shumë se 800 mijë refugjatëve, personave të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës.

Republika e Kosovës edhe në këtë përvjetor të çlirimit ka para vetes shumë sfida, njëra ndër to është edhe dialogu me Serbinë, Gjykata Speciale, mosliberalizimi i vizave, një procesi i stërzgatur, procesi i vetingut për të cilin është folur shumë dhe mungesa e një zhvillimi më të mirë ekonomik.

Aleatët ndërkombëtarë urojnë Kosovën

Në 21-vjetorin çlirimit Kosova ka pranuar urime të shumta nga aleatët e saj, të cilët ndihmuan në arritjen e ditës së lirisë. Ish-udhëheqës të NATO-s, senatorë e diplomatë amerikanë dhe evropianë, janë ndier të lumtur që kanë kontribuar në çlirimin e Kosovës.

Ish-sekretari i përgjithshëm i NATO-s gjatë kohës së luftës, Lord George Robertson, ka thënë se ndihet krenar me veprimet e tij. "Ju shpreh urretimet e mia me rastin e Ditës së Çlirimit në Kosovë! Kosova është vend i pavarur dhe vend shumëtnik, në paqe me vendet e rajonit dhe në rrugë të mbarë për ta zënë vendin e merituar në Evropë dhe kjo ma mbushë zemrën me krenari", ka thënë Robertsoni.

Ai ka thënë se shumë njerëz nuk



KOSOVËN E PRESIN SFIDA



mund ta imagjinojnë se si do të ishte Kosova pas 21 vjetësh. “Gëzohem si qytetarët kanë përparuar në një shkallë që shumë njerëz 21 vjet më parë as nuk do të mund ta imagjinojnë”, është shprehur Robertsoni, duke shtuar se sfidë për Kosovën dhe botën aktualisht është pandemia Covid-19. “E ardhmja do të jetë e vështirë edhe për Kosovën pas kësaj pandemie, por jam i sigurt se shpirti kosovar që ju ka udhëzuar për 21 vjet për ta ndërtuar shtetin do t’iu mundësojë që ta kaloni edhe këtë sfidë që po përballet gjithë bota. Ju uroj për ditën e lirisë!”, ka thënë Robertsoni në urimin e tij. Një ndër përkrahësit më të fuqishëm të Kosovës, senatori Bob Dole, ka uruar Kosovën me rastin e 21-vjetorit të çlirimit. Përmes një video-mesazhi, Dole ka thënë se është i lumtur që ishte pjesë e procesit të çlirimit të Kosovës. “Përshëndetje për të gjithë miqtë e mi në Kosovë. Jam i lumtur që isha pjesë e këtij procesi. U mundova të bëja gjithçka që është e mundur për këtë ditë, por ishte populli i shtetit tuaj të mrekullueshëm që e bëri këtë të mundur. Unë jam këtu për çfarëdo ndihme që mund t’ju ofroj dhe nëse mund t’ju ofroj asistencë, ju vetëm më telefononi. Ju falënderoj shumë. Faleminderit për gjithçka që keni arritur! Zoti ju bekoftë të gjithëve!”, ka thënë senatori Dole.

Senatori Dole ishte ndër të parët i cili ishte përpjekur me vendosmëri për të përcaktuar vija të kuqe të ndalimit të

gjenocidit serb ndaj popullsisë civile shqiptare në Kosovë.

E ish-kryeministri i Italisë, Massimo D’Alema, ka thënë se është momenti që Kosova të integrohet në Bashkimin Evropian, duke shtuar se për këtë duhet guxim. “Mbah mend angazhimin e Rugovës të cilin kam nderin të them se isha shoku i tij. Kosova po bën ecjen kaluese, tani më është shtet i pavarur, i njohur nga shumë shtete dhe i mbështetur nga shumë shtete që i takojnë Perëndimit. Ndër këto, edhe Italia, që ishte ndër të parat që njohu pavarësinë e Kosovës”, ka thënë ai.

Edhe ambasadori gjerman në Prishtinë, Christian Heldt, ka thënë se kjo ditë duhet të shërbejë si kujtim për viktimat, por edhe për obligimet që ka shteti për të ardhmen. “Sot, 21 vjet më parë, NATO-ja i dha fund një konflikti të tmerrshëm. U jam mirënjohës mbi 50 000 ushtarëve që kanë shërbyer në Kosovë që atëherë. Përkulem ndaj viktimave. Ata na kujtojnë për arritjet që kemi bërë që atëherë, por edhe për obligimet që duhet të përmbushen. Ne qëndruam dhe vazhdojmë të qëndrojmë për një shtet demokratik, shumetnik, me sundim të pavarur të ligjit, për shërbimin e politikës për vendin dhe njerëzit, për media kritike dhe të pavarura, për liritë themelore dhe jo për një shtet që është si dhuratë për disa persona”, ka shkruar Heldt.

Në këtë ditë historike, Kosovën e kanë uruar edhe liderët e Shqipërisë.

Presidenti i Shqipërisë, Ilir Meta, ka thënë se në 21-vjetorin e çlirimit të Kosovës kujtojmë me nderim të jashtëzakonshëm jetën dhe veprën e ish-presidentit Ibrahim Rugova, komandantit legjendar Adem Jashari dhe të gjithë atyre që

kontribuan për arritjen e lirisë së Kosovës. Ndërsa kryeministri shqiptar Edi Rama ka thënë se 10 qershori i vitit 1999 ishte një ditë e bekuar që kurrë nuk do të ikë prej kujtesës sonë kombëtare. Kosovën për këtë ditë e ka uruar edhe lideri i shqiptarëve të Maqedonisë, Ali Ahmeti.

Misioni i KFOR-it mbetet i pandryshuar

Në orët e para të 12 qershorit të vitit 1999 kontingjentet nga shumë shtete hynë në Kosovë nën shenjën e KFOR-it dhe

Përmirësimi i sigurisë në terren ka çuar në zvogëlim progresiv të KFOR-it nga 55 000 trupa sa ishin në vitin 1999 në rreth 3 500 trupa tani.

Ushtarët nga 27 shtete, nën komandën e gjeneralmajorit italian Michele Risi, përbëjnë një formacion të fortë, të besueshëm dhe parandalues, të cilët e shfaqin të njëjtën frymë, angazhim dhe entuziazëm sikurse pararendësit e tyre.

Misioni i KFOR-it mbetet i pandryshuar, ndërsa KFOR-i mbetet një faktor i domosdoshëm i stabilizimit për

deklaruar gjeneral Risi me rastin e përvjetorit të KFOR-it.

KFOR-i, gjithashtu, e përkrahu reagimin ndaj pandemisë Covid-19 në mënyra të ndryshme, duke përfshirë edhe dhurimin e sasive të konsiderueshme të pajisjeve për mbrojtje personale dhe ndihmën me dërgesat e përkrahjes dypalëshe nga shtetet aleate që kontribuojnë me trupa në KFOR, si për shembull, Austria, Italia, Polonia dhe Shtetet e Bashkuara për shumë komuna të Kosovës. Aftësia e KFOR-it, për të kryer



filluan misionin e udhëhequr nga NATO-ja që të premtën shënuan përvjetorin e 21-të. Nga ajo kohe, Kosova hyri në një periudhë të re të paqes dhe zhvillimit, gjithashtu falë kontributit të KFOR-it për mjedis të qetë dhe të sigurt si dhe liri të lëvizjes për të gjithë qytetarët në Kosovë, pavarësisht nga përkatësia etnike e tyre.

të ardhmen e Kosovës dhe për sigurinë rajonale. “Besoj fuqishëm se situata stabile nga perspektiva e sigurisë është kusht i domosdoshëm për dialog dhe për bashkëpunim. KFOR-i do të vazhdojë ta japë kontributin e tij për ta kapërcyer situatën drejt një të ardhmeje më të ndritshme për gjeneratat më të reja të Kosovës”, ka

operacione ditore, nuk është zvogëluar nga virusi, trupat kanë vazhduar patrullimin dhe ekipet ndërlidhëse dhe monitoruese kanë vazhduar realizimin e aktiviteteve të tyre, duke i ndërmarrë të gjitha masat parandaluese në përputhje me udhëzimet e Organizatës Botërore të Shëndetësisë.



Në shenjë kujtimi për fëmijët e vrarë, në oborrin e Kuvendit mbillen 1 133 lule

Pas seancës solemne të Kuvendit, kryetarja Vjosa Osmani dhe deputetët të tjerë dolën në oborrin e Kuvendit ku, në shenjë kujtimi për fëmijët e vrarë gjatë luftës së fundit, janë mbjellë 1 133 lule. Kryeparlamentarja Osmani tha se kujtimi për 1 133 fëmijët e vrarë do të jetë i përhershëm. “Në kujtim të 1 133 fëmijëve të vrarë gjatë luftës në Kosovë, luleve të bardha të Kosovës, që u këputën ende pa çelur mirë, me ëndrrën e fjetur mbi ballë, por që u shndërruan në lulen e lirisë së saj. Këtu i kemi 1 133 lule që do t’i mbjellim bashkë me deputetët e pranishëm, në kujtim të përhershëm të secilit prej tyre”, ka theksuar Osmani.

20 ventilatorë mobilë iu dorëzuan QKUK-së

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) në Kosovë si reagim të menjëhershëm ndaj Covid-19 i ka dorëzuar të premtën 20 ventilatorë e parë mobilë Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) të blera me fonde të Qeverisë së Norvegjisë, Zvicrës dhe Luksemburgut. Këta ventilatorë do ta ngrehin kapacitetin e kujdesit intensiv të sektorit shëndetësor të Kosovës.

Gjatë dorëzimit të sotëm në QKUK ishin të pranishëm Armend Zemaj ministër i Shëndetësisë, Maria Suokko, përfaqësuese e përhershme e UNDP-së, si dhe përfaqësues të donatorëve, Sh. T. Jens Erik Grondahl, ambasador i Norvegjisë dhe Sh. T. Jean-Hubert Lebet, ambasador i Zvicrës.

Kontributi i përgjithshëm nga Qeveria e Norvegjisë, Zvicrës dhe Luksemburgut për blerjen e ventilatorëve mobil Vg70 është 1,17 milion dollar, në partneritet me UNDP-në. Falë kësaj mbështetjeje UNDP-ja ka blerë 40 ventilatorë, 20 prej të cilëve u dorëzuan sot, ndërsa pjesa tjetër do të dorëzohet deri në fund të muajit qershor.

Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, i cili ka pranuar donacionin në emër të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës (QKUK), ka theksuar rëndësinë e këtij bashkëpunimi. "Është nder për mua ta pranoj këtë donacion në emër të Qendrës Klinike Universitare të Kosovës. Dua ta falënderoj qeverinë e Norvegjisë, të Zvicrës dhe të



Luksemburgut për fondet dhe UNDP-në për blerjen e ventilatorëve mobilë që do të shpëtojnë jetë. Ne vlerësojmë lart kontributin dhe mbështetjen tuaj për sistemin shëndetësor në Kosovë në menaxhimin e pandemisë Covid-19. Ministria e Shëndetësisë është e përkushtuar t'i vazhdojë projektet e përbashkëta edhe në të ardhmen pasi ta mposhtim krizën", ka thënë ai.

Ministri Zemaj ka theksuar se nuk ka dhuratë më të mirë për qytetarët e Kosovës në Ditën e Çlirimit sesa një asistencë e rëndësishme për pacientët.

"UNDP-ja qëndron bashkë me qytetarët dhe institucionet e Kosovës dhe partnerët ndërkombëtarë në luftën kundër Covid-19 dhe për të reaguar ndaj ndikimeve të shkaktuara nga pandemia. Donacioni i sotëm u bë i mundur përmes kontributit bujar nga Qeveria e Norvegjisë, e Zvicrës dhe e Luksemburgut. Dhe ne jemi jashtëzakonisht mirënjohës që ata bashkëpunuan me ne në mbështetje të Kosovës në këto kohë të vështira. Ne jemi të përkushtuar ta mbështesim Kosovën për t'i ngritur kapacitetet e kujdesit

shëndetësor - në përballimin e pandemisë dhe përtej", ka thënë me këtë rast Maria Suokko, përfaqësuesja e përhershme e UNDP-së. "Në një kohë shumë të vështirë, që po shkakton presion të jashtëzakonshëm në shërbimet e shëndetit publik, është e domosdoshme të shfaqim solidaritet dhe të bëjmë gjithçka që mund për ta ndihmuar njëri-tjetrin dhe për t'i forcuar përpjekjet tona të përbashkëta për mposhtjen e pandemisë. Prandaj, Norvegjia është krenare t'i mbështesë përpjekjet e qeverisë kundër pandemisë Covid-19 duke siguruar fonde për blerjen e

menjëhershme të ventilatorëve për spitalet në një bashkëpunim të pakrahasueshëm me Dukatën e Madhe të Luksemburgut, Agjencinë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe Programin e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim në Kosovë", është shprehur ambasadori Grondahl. "Si partnere afatgjatë në zhvillimin social dhe ekonomik të Kosovës, Zvicra është e lumtur të qëndrojë me Kosovën edhe në luftën kundër Covid-19. Pajisjet që dorëzohen sot rrisin kapacitetin e sistemit të brishtë shëndetësor për të ofruar shërbime adekuate për pacientët që vuajnë nga Covid-19 si dhe sëmundje të tjera të rënda të frymëmarrjes. Ne inkurajojmë qeverinë e Kosovës që të vazhdojë ta menaxhojë përgjigjen (ndaj pandemisë) në mënyrë efektive dhe përgëzojmë profesionistët shëndetësorë dhe shërbyesit e tjerë të linjës së parë për përkushtimin e tyre në luftën kundër Covid-19 deri më tani, duke mbrojtur kështu jetën dhe shëndetin e qytetarëve të Kosovës", ka thënë ambasadori Lebet.

UNDP-ja ka bërë me dije se ventilatorët janë prodhuar në Kinë, të certifikuar me certifikatën e BE-së dhe me sigurimin e cilësisë nga Njësia Globale e Prokurimit e UNDP-së në Kopenhagë.

Që nga shpërthimi i Covid-19, UNDP-ja në Kosovë, si agjenci kyçe e ekipit të OKB-së në Kosovë (UNKT), është duke mbështetur qytetarët dhe institucionet e Kosovës që të përgatiten, t'i përgjigjen në mënyrë sa më adekuate pandemisë, duke u përqendruar veçanërisht në më të prekurit.

Kryeministri Hoti vlerëson rolin e pazëvendësueshëm të shteteve të Quint-it

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Kryeministri i Republikës së Kosovës, Avdullah Hoti, të premtën ka pritur në takim ambasadorët e shteteve të Quint-it, me të cilët ka biseduar rreth aktualitetit politik dhe ekonomik në vend. Në këtë takim, në të cilën e pranishme ishte edhe shefja e Zyrës së Bashkimit Evropian/Përfaqësuesja e Posaçme e BE-së në Kosovë, Nataliya Apostolova, kryeministri Hoti i njoftoi ambasadorët për prioritetet e Qeverisë së Kosovës, angazhimin maksimal për rimëkëmbjen ekonomike, luftën kundër pandemisë Covid-19 si dhe për përkushtimin e Qeverisë së Kosovës në rifillimin e procesit të dialogut në funksion të stabilitetit rajonal dhe normalizimit të marrëdhënieve ndërfqinjësore.



Kryeministri Hoti vlerësoi rolin e pazëvendësueshëm të shteteve të Quint-it për mbështetjen e vazhdueshme që i kanë dhënë shtetit të Kosovës në të gjitha fazat e zhvillimit dhe të

shtetndërtimit. Kryeministri Hoti të premtën ka pritur në takim edhe komandantin e KFOR-it, gjeneralmajor Michele Risi, me të cilin ka biseduar për

zhvillimet e përgjithshme në vend, veçanërisht për situatën e sigurisë. Po ashtu, Hoti ka pritur në takim edhe ambasadorën e Francës në Kosovë, Marie Christine Butel. Me këtë rast,

kryeministri Hoti e falënderoi ambasadorën Butel për përkrahjen që Franca si një partnere e fuqishme në proceset e deritanishme eurointegruese, i ka dhënë vazhdimisht Kosovës.

Pas shtimit të rasteve, mblidhet komiteti për vlerësimin e situatës emergjente me Covid-19

Zemaj: Lirimi i veprimtarive të tjera varet nga zbatimi i masave në ato që janë liruar



Në takimin e Komitetit për koordinimin dhe vlerësimin e situatës emergjente me Covid-19, ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë se është evidente se lirimi i shumë veprimtarive përgjatë fazës së II dhe të III të hapjes graduale ka sjellë edhe shtimin e rasteve pozitive në Covid-19 por, sipas tij, kësaj duket që i ka kontribuar edhe ulja e kujdesit nga vetë qytetarët. Ai ka kërkuar nga inspektoratet që secili brenda fushëveprimtarisë së tij, t'i mbikëqyrë dhe zbatojë masat e ndërmarra, në veçanti në sektorin e gastronomisë, ku mospërfillja e tyre është e theksuar

veprimtarive përgjatë fazës së II-të dhe të III-të të hapjes graduale ka sjellë edhe shtimin e rasteve pozitive në Covid-19, por kësaj duket se i ka kontribuar edhe ulja e kujdesit nga vetë qytetarët, por edhe moszbatimi adekuat i masave mbrojtëse nga ana e bizneseve dhe subjekteve, veprimtaritë e të cilave janë liruar”, ka thënë ai. Ai ka kërkuar nga inspektoratet që secili brenda fushëveprimtarisë së vet t'i mbikëqyrë dhe zbatojë masat e ndërmarra, në veçanti në sektorin e gastronomisë, ku mospërfillja e tyre është e theksuar.

Ministri Zemaj ka thënë se duhet analizuar edhe procesin në shkolla dhe institucione edukative, ndërkohë që ka kërkuar nga secili sektor për fushën e veprimtarive së vet që të jetë më shumë përgjegjës për implementimin e masave të marrë secili në fushën e vet si në asistencë me udhëzues apo rekomandime, po ashtu edhe me implementim.

Ministri i Punëve të Brendshme, Agim Veliu, ka thënë se MPB-ja do t'i respektojë dhe do të veprojë sipas të gjitha rekomandimeve që jep MSh dhe institucionet e tjera përgjegjëse në menaxhimin e pandemisë Covid-19 dhe bashkë me agjencitë e saj do t'i zbatojë masat. Drejtori i IKShPK-së, Naser Ramadani, si kryesues i grupit të përbashkët me MSh-në, i dorëzoi ministri Zemaj draftmanualin që do t'u shërbejë veprimtarive të lejuara dhe atyre që do të lirohen në të ardhmen me udhëzimet për parandalim dhe mbrojtjen nga Covid-19 gjatë ushtrimit të veprimtarive.

**EPOKA
ERE****Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka thënë të premten se do të jetë vështirë të shkohet me lirimin e masave për veprimtari të tjera përderisa në veprimtari të lejuara përgjatë fazës së dytë dhe të tretë të hapjes graduale nuk respektohen masat e marra nga

qeveria e vendit dhe rekomandimet e IKShPK-së. “Disa veprimtari të tjera të parapara për t'u rivlerësuar në fazën e III-të duhen marrë me shumë kujdes për shkak në njërin anë të presionit të madh që vjen prej tyre për t'u liruar, në anën tjetër rrezikut të përhapjes së virusit, pasi që shumica prej tyre kanë të bëjnë me fluks të madh të qytetarëve që gravitojnë në to apo që janë

pjesëmarrës dhe në veprimtari të lejuara respektimi i masave nuk po ndodh”, ka thënë ai në takimin e komitetit për koordinimin dhe vlerësimin e situatës emergjente me Covid-19, në të cilin është bisedua për situatën aktuale rreth pandemisë në Kosovë. Ai ka theksuar se duhet vazhduar me një përcjellje aktive të situatës lidhur me Covid-19 me qëllim të

parandalimit të përhapjes së mëtejme të virusit dhe mbajtjes në kontroll të tij. “Të vetëdijshëm për numrin në rritje të rasteve që kanë rezultuar pozitive në Covid-19 ditët e fundit, jemi të obliguar që të ndërmarrim masa adekuate me qëllim që ky numër të mos kthehet në ngarkesë për spitalet tona dhe personelin shëndetësor. Është më se evidente se lirimi i shumë

Nisma Socialdemokrate shpall zgjedhjet e brendshme



PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Nisma Socialdemokrate, në mbledhjen e saj me anëtarët e kryesisë dhe kryetarët e degëve, ka marrë vendim për t'i shpallur zgjedhjet e brendshme të partisë, proces i cili

parashihet të përmbyllet deri në dhjetor të këtij viti. Kryetari Limaj në këtë mbledhje kërkoi nga kryetarët e degëve që pas përfundimit të pandemisë t'i fillojnë përgatitjet për orga-

nizimin e kuvendeve zgjedhore nëpër degët e Nismës. Po ashtu, ai tha se subjekti ynë politik duhet të hapet edhe më shumë për kuadro të reja. Kryetari Limaj, gjithashtu, ka

kërkuar që gjatë këtij procesi të brendshëm zgjedhor t'u krijohen kushtet dhe mundësitë të gjithë të interesuarve që kanë vullnet dhe dëshirë për të marrë përgjegjësi për t'i shërbyer

komitetit përmes subjektivitetit tonë politik. Me formimin e Komisionit Punues do të bëhet publik edhe orari dhe detajet e tjera në funksion të mbarëvajtjes së këtij procesi zgjedhor.

12 Qershori - Dita e Çlirimtarëve të Kosovës



Lulëzim ETEMAJ

21 vjet më parë, në ditën e 78-të të sulmeve ajrore të NATO-s kundër forcave ushtarake dhe objekteve strategjike të Serbisë, në mbrëmjen e 9 qershorit 1999 në Kumanovë u nënshkrua Marrëveshja Teknike-Ushtarake. Millosheviqi dhe qeveria e tij tanimë me barrën e rënduar të genocidit dhe krimeve të luftës në shpinë pranuan kapitullimin në Kosovë. Ish-sekretari gjeneral i NATO-s, Javier Solana, me këtë rast shprehet prerazi: "NATO do t'i suspendojë sulmet ajrore sa

më shpejt që të verifikohet respektimi i armëpushimit dhe fillimi i tërheqjes së forcave ushtarake serbe".

Kështu "mbaroj një luftë e cila ishte e drejtuar kundër vlerave perëndimore dhe civilizimit evropian... mbaroj një luftë e cila me siguri Kosovën do ta kishte zbratur nga popullata e saj autoktone shqiptare dhe do t'i kishte destabilizuar të gjitha vendet fqinje", shkruan në ditarin e tij ish-ministri gjerman i Mbrojtjes, Rudolf Scharping. Për t'u përballur me situatën e pas tërheqjes së trupave ushtarake, policore dhe parashtarake serbe nga Kosova, ministrat e mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s pasdite arritën pëlqimin dhe i dhanë dritën e gjelbër trupave paqësore ndërkombëtare, KFOR. Më 10 qershor 1999, Këshilli i Sigurimit i OKB-së aprovon dërgimin e

trupave të KFOR-it në Kosovë dhe ngarkon e OKB-në, përmes Rezolutës 1244, me ndërtimin e administratës së përkohshme vendore. Më 12 qershor fillon marshimi i trupave paqësore ndërkombëtare në Kosovë. Një pjesë e trupave gjermane, të vendosura në Maqedoni, stacionohet në kufi me Shqipërinë, ndërsa një numër i tyre së bashku me amerikanët dhe britanikët përmes Shkupit marshojnë në Prishtinë. Të tjerët përmes rrugëve të vështira malore të Shqipërisë arrijnë në Prizren.

Aeroporti i Prishtinës tanimë ishte futur nën kontrollin e forcave ruse që ishin të stacionuara në Bosnjë në përbërje të SFOR-it, të cilat kishin filluar marshimin në Kosovë që me natë. Ushtarët e Aleancës së NATO-s, ashtu si dhe ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u



pritën nga qytetarët shqiptarë të Kosovës si çlirimtarë: me duartrokitje, buqeta lulësh, përqaftime e lot gëzimi e shpresë në sy. Trupat paqësore ndërkombëtare, në përpjekje të krijimit të rendit dhe qetësisë, shënojnë kontakte të ngushta me komandantët e UÇK-së. Ndërsa refugjatët shqiptarë të Kosovës, të strehuar me zemërgjerësi shembullore në Shqipëri, si dhe

ata në Maqedoni, s'mund t'i ndalë asgjë, as vërejtjet për rreziket nga fushat e minuara përgjatë brezit kufitar, për t'u kthyer sa më parë në shtëpitë e tyre prej nga i kishte dëbuar dhuna serbe. Për t'u kthyer në Kosovën e lirë.

Tashmë kishte aguar dita e re, dita e parë e epokës së shumëpritur ndër breza nga shqiptarët - epokës së lirisë së Kosovës.



MPB-ja do t'i monitorojë provimet për patentë shoferë



PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Agim Veliu, dhe ai i Ministrisë së Infrastrukturës (MI), Arban Abrashi, kanë nënshkruar të premtën një memorandum bashkëpunimi. Ky memorandum ka për qëllim marrëveshjen në mes të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Infrastrukturës për pjesëmarrjen e stafit të autorizuar nga MPB-ja në cilësinë e vëzhgimit në provimet

për shofer si dhe përshkrimin e kushteve dhe mënyrën e pjesëmarrjes së zyrtarëve të MPB-së.

Në zbatim të nenit 124 të Ligjit Nr. 05/L-064 për patentë shoferë, pjesëmarrës në mbikëqyrjen e mbajtjes së provimeve do të jenë edhe zyrtarë të autorizuar të MPB-së. Gjithashtu, MI-ja ka siguruar se në testimet për patentë shoferë do të përfshihen zyrtarët e autorizuar nga MPB-ja.

Më tej, në këtë memorandum është thënë se zyrtarët e autorizuar nga MPB-ja dhe MI-ja do të angazhohen me vendim të ministrit të MI-së.

Me nënshkrimin e memorandumit MI-ja dhe MPB-ja pajtohen që të dhënat nga pjesëmarrja në teste të jenë konfidenciale dhe, si të tilla, do të përdoren vetëm për qëllime të këtij memorandumit dhe të njëjtat nuk do të shpërndahen te palët e tjera të paautorizuara.

Ministri Likaj takohet me kryetarin Suma, bisedojnë për funksionalizimin e çerdhes në Han të Elezit

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Ministri i Arsimit dhe Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHIT), Ramë Likaj, ka pritur të premtën në takim kryetarin e Komunës së Hanit të Elezit, Rufki Suma, me të cilin ka biseduar rreth gjendjes në

arsim në këtë komunë. Kryetari Suma ka shprehur shqetësimin e tij për mospërfshirjen e fëmijëve të kësaj komune në edukimin parashkollor. Ai ka theksuar se e vetmja çerdhe e cila është ndërtuar nga Komuna e hanit të

Elezit, ka tri vjet që është e gatshme dhe e pajisur, por në mungesë të buxhetit dhe mungesës së stafit, ende nuk është funksionale, edhe pas shumë përpjekjeve të komunës. Ndërsa ministri Likaj ka theksuar se përfshirja e

fëmijëve në edukimin parashkollor është vendosur si një nga prioritetet kryesore, prandaj ka theksuar gatishmërinë e tij që t'i shtyjë përpara proceset që kjo çerdhe të funksionalizohet sa më shpejt që të jetë e mundur.



Bordi i përkohshëm i 'Trepçës' nuk e pranon vendimin e inspektoratit për Basri Ibrahimin

EPOKA
ERE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Bordi i përkohshëm i "Trepçës", i emëruar nga qeveria Kurti, në mbledhjen që ka mbajtur ditën e djeshme, ka vendosur që ta dërgojë në shkallë të dytë vendimin e Inspektoratit të Punës që ishte pro kthimit në vendin e punës të ish-kryeshefit të "Trepçës" Basri Ibrahimit. Lidhur me këtë, ish-kryeshefi ekzekutiv i kombinatit "Trepça", Basri Ibrahimit, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se është vendosur që çështja e tij të

shkojë në shkallë të dytë dhe, sipas tij, vendimi është i kundërligjshëm pasi Bordi i Përkohshëm nuk ka pasur kuorumin e mjaftueshëm.

"Me sa kam marrë informata ata kanë vendosur që këtë çështje ta dërgojnë në shkallë të dytë, por ju themi se ky vendim është i kundërligjshëm pasi ai bord fillimisht nuk ka pasur kuorum dhe përbëhet nga katër persona. Unë do ta pres vendimin e shkallës së dytë, megjithatë nuk ka asnjë bazë ligjore pasi është konstatuar se nuk ka kuorum", ka thënë Ibrahimit.

Kurse kryesuesi i bordit të përkohshëm të "Trepçës", Hysen Sylejmani, ka thënë se bordi ka plotësisht të drejtë që të marrë vendim edhe me katër anëtarë.

"Ne kemi vendosur që çështjen e inspektoratit ta dërgojmë në shkallë të dytë, pasi kemi konstatuar se ne duhet të veprojmë konform ligjit. Ne kemi drejtë të marrim vendime dhe kemi kuorum, pra edhe me katër anëtarë. Duhet ta kuptojnë se ne jemi bord i përkohshëm, pra mjaftojnë katër anëtarë, e jo nëntë anëtarë siç pretendojnë", ka thënë Hyseni.



Banka Botërore përkrah projektet bujqësore

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Ministri i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Besian Mustafa, të premten ka zhvilluar një takim virtual me misionin e Bankës Botërore, të udhëhequr nga menaxheri i Zyrës së BB-së në Kosovë, Marco Mantovanelli dhe përgjegjësën e ekipit për sektorin e bujqësisë, Silvia Mauri, me të cilët ka diskutuar për format e bashkëpunimit në realizimin e projekteve konkrete në kuadër të Projektit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural të BB-së.

Ministri Mustafa i ka njoftuar ata me objektivat dhe prioritetet e MBPZHR-së në kuadër të Programit për Zhvillim

Rural dhe atë të Pagesave Direkte, me ç'rast përfaqësuesit e BB-së i kanë konfirmuar mbështetjen në realizimin sa më efikas të këtyre programeve bujqësore.

Menaxheri i Zyrës së BB-së, Marco Mantovanelli, ka vlerësuar punën dhe angazhimin që po bëhet në bujqësi, si dhe ka konfirmuar vazhdimin e mbështetjes përmes Projektit për Bujqësi dhe Zhvillim Rural, në projektet për monitorimin dhe mbikëqyrjen e granteve investive, si dhe në projektet e ujitjes, që për qëllim kanë avancimin e bujqësisë dhe tejkalimin e sfidave në këtë sektor.



Reçica: Do të angazhohemi që të kemi sa më pak raste të fëmijëve që merren me punë të rënda

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skënder Reçica, me rastin e shënimit të Ditës Ndërkombëtare Kundër Punës së Fëmijëve, ka zhvilluar takimin e rregullt vjetor të Komitetit të Kosovës për Parandalimin dhe Eliminimin e Punëve të Rënda të Fëmijëve.

Me këtë rast, ministri Reçica foli për angazhimin dhe përpjekjet që janë bërë edhe në mandatin e kaluar në funksion të mbrojtjes së fëmijëve nga punët e rënda, megjithëse për t'i arritur synimet

tona, tha ai, na mbetet ende shumë punë për të bërë tani e tutje. "MPMS-ja së shpejti pritet t'i nxjerrë aktet nënligjore që parashihen edhe me Ligjin për Mbrojtjen e Fëmijëve, ligj ky i miratuar në mandatin e kaluar, me ç'rast do të ketë më shumë qartësi në aspektin ligjor për trajtimin e kësaj dukurie të dëmshme për fëmijët", u shpreh ministri Reçica. Gjithashtu, ministri Reçica ka theksuar angazhimin e tij që të ketë sa më pak raste të përfshirjes së fëmijëve që merren me punë të rënda.

Shqyrtohet raporti i auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2019

PRISHTINË, 12 QERSHOR (ER) - Komisioni për Mbikëqyrjen e Financave Publike, i drejtuar nga zëvendëskryetari i parë Enver Haliti, të premten ka shqyrtuar raportin e auditimit për pasqyrat financiare të Ministrisë së Mbrojtjes për vitin 2019.

Në emër të komisionit prezantimin e raportit në mënyrë të përmblodhur e bëri deputeti Sejdi Hoxha, si deputet raportues, i cili foli për të gjeturat konkrete dhe rekomandimet e dhëna nga

Zyra Kombëtare e Auditimit, duke u fokusuar në tri pika kryesore. "Ky opinion është i pamodifikuar dhe do të ketë vetëm tri pika kryesore. Do të jetë opinioni i auditorit për pasqyrat financiare vjetore për vitin 2019, menaxhimi financiar dhe kontrolli, si dhe interesi i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi", ka theksuar Hoxha.

Anton Quni, ministër i Ministrisë së Mbrojtjes, para komisionit theksoi nevojën e bashkëpunimit, duke shprehur gatishmërinë për t'i

përbushur obligimet e dala nga raporti i auditimit. "Që nga momenti që kemi marrë rezultatet e auditorit, ne kemi lëshuar vendimin që këto të gjetura t'i adresojmë me qëllim që të merren masat e duhura ligjore për evitimin e tyre", ka thënë Quni. Po ashtu, edhe përfaqësuesi i Zyrës Kombëtare të Auditimit, Zuke Zuka, foli për raportin në fjalë duke paraqitur shkaqet për çështjet e caktuara dhe të gjeturat. Ai tha se të gjeturat e raportit do t'i ndihmojnë procesit si tërësi.



Më 25 qershor në Gjilan do të bëhet inaugurimi i shtatores së Abdullah Tahirit

GJILAN, 12 QERSHOR (ER) - Komuna e Gjilanit, nën përkudjesjen e kryetarit Lutfi Haziri, ka nisur realizimin e kalendarit të festës së çlirimit të Gjilanit dhe Kosovës, i cili në vete përfshinë një mori aktivitete që kanë nisur nga dje më 11 qershor dhe do të vazhdojnë deri të hënën më 15 qershor, me qëllim të nderimit, respektit dhe sakrificës për vuajtjet dhe gjakun e derdhur të shumë qytetarëve në luftën për liri. Në paraqitjen e kalenderit të aktiviteteve, drejtoresha e Kulturës, Deniza Limani, ka konfirmuar se më 25 qershor do të bëhet inaugurimi i shtatores

së Abdullah Tahirit, të cilit i kushtohen të gjitha aktivitetet kulturore. “Nga dita e djeshme aktivitetet në shënim të lirisë së Gjilanit kanë nisur me ndarjen e çmimit ‘Beqir Musliu’, sot është mbledhja solemne e bordit të drejtorëve për t’i koordinuar edhe më tutje të gjitha aktivitetet. Në ditën e nesërme është aktiviteti i mbjelljes së luleve në kujtim të 21-vjetorit të lirisë. Më 14 qershor është e paraparë ceremonia e ndarjes së çmimit ‘Beqir Musliu’ për të vazhduar me videon online të fëmijëve të lindur në vitin 2008, i cili njihet si shtegu i lirisë”, ka thënë në



prezantimin e saj drejtoresha Limani.

Ajo ka njoftuar se më 15 qershor, kur edhe është mani-

festimi qendror, aktivitetet janë edhe më të shumta. “Të hënën më 15 qershor fillojnë aktivitetet me homazhe në varrezat e dëshmorëve, për t’i vijuar aktivitetet me ndarjen e çmimit ‘Agim Ramadani’, ‘Idriz Seferi’, ‘Hanumshahe Abdullahu’. Do të kemi edhe program kulturor për qytetarët gjilanas dhe shfaqje teatrale online për tri ditë me radhë. Gjithashtu, është paraparë edhe ndarja e mirënjohjeve në fushën e kulturës, rinisë, sportit, artit, muzikë, letërsi, art vizual për të cilën është duke punuar komisioni profesional”, ka thënë ajo.

Humanisti Halil Kastrati shpallet ‘Qytetar Nderi’ i Komunës së Lipjanit



LIPJAN, 12 QERSHOR (ER) - Kryetari Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, zyrtarisht të premtën ia ka dorëzuar “Çelësin e Qytetit” dhe ka shpallur “Qytetar Nderi” humanistin nga Shoqata Bamirëse “Jetimat e Ballkanit”, Halil Kastrati. Ky çmim dhe ky nderim bërë Kastrati është bërë me propozimin e kryetarit të Komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti dhe me miratimin e

Asamblesë Komunale në seancën e fundit.

Kryetari Imri Ahmeti me këtë rast ka thënë se është ndër dhe krenari për Lipjanin që po shpall “Qytetar Nderi” humanistin Halil Kastrati në shënimin e 12 Qershorit - Ditës së Çlirimit të Komunës së Lipjanit. Ndërkaq humanisti Halil Kastrati ka falënderuar kryetarin Ahmeti dhe ka shtuar se nga sot ka përgjegjësi shtesë

në punën dhe angazhimin tij gjë që bënë edhe më të ndërgjegjshëm dhe më të përgjegjshëm për të gjitha aktivitetet e mëtutjeshme në veprimtarinë e tij humane dhe se është nder për të jetë qytetar nderi i Komunës së Lipjanit. Humanisti Kastrati, së bashku me shoqatën e tij “Jetimat e Ballkanit”, ka ndihmuar qindra familje me nevojë në territorin e Komunës së Lipjanit.

Vazhdon dezinfektimi i zonave endemike në Malishevë

MALISHEVË, 12 QERSHOR (ER) - Në kuadër të zbatimit të strategjisë nacionale për parandalimin dhe luftimin e etheve hemorragjike krime kongo (EHKK), pas një pauze disaditore për shkak të kushteve atmosferike, të premtën ka vazhduar fushata e dezinfektimit të zonave endemike. Dezinfektimi bëhet kundër rriqrave të cilët janë bartës të virusit të EHKK-së. “Sot janë duke u dezinfektuar zonat e caktuara në fshatin Dragobil, ndërsa më pas pritet të vazhdohet me këtë fushatë të dezinfektimit në qytetin e Malishevës dhe periferinë e saj. Me dezinfektim përfshihen të gjitha hapësirat publike dhe private në territoret e caktuara, të cilat vlerësohen si zona endemike dhe potencialisht mund të ketë prani të rriqrave dhe virusit të EHKK-së”, ka njoftuar Komuna e

Malishevës. Në këtë njoftim theksohet se fushata e dezinfektimit është duke u pritur mirë nga banorët, përderisa vendbanimet paraprakisht njoftohen në mënyrë që t’i marrin masat e nevojshme preventive, në veçanti bletarët. “Dezinfektimi i zonave endemike është pjesë e strategjisë nacionale të hartuar nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike (IKShP) dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për luftimin dhe parandalimin e EHKK. Që nga viti 2014 në Komunën e Malishevës nuk është regjistruar asnjë rast i prekur apo që ka pësuar me fatalitet si pasojë e infektimit me virusin e EHKK, virus i cili te njeriu bartet përmes rriqrave dhe ky është viti i gjashtë me radhë që nuk ka raste të infektimit me EHKK”, është bërë me dije në njoftimin e Komunës së Malishevës.



Vazhdon të mirëmbahet ambienti në qytetin e Suharekës

SUHAREKË, 12 QERSHOR (ER) - Për një ambient të pastër, të bukur dhe të gjelbëruar e të stolisur me lloje të ndryshme të luleve, po kujdeset kryetari i Komunës së Suharekës, Bali

Muharremaj, i cili vazhdimisht interesohet dhe përcjell çdo ditë pjesët e ndryshme të qytetit dhe jo vetëm të qytetit, por edhe të fshatrave të komunës.

Muharremaj në llogarinë e vet në “Facebook” ka publikuar fotografi, në të cilat duken duke u pastruar sheshi “Fadil Vata” dhe ai “Besim Ndrecaj”. “Kujdesi dhe puna

do të jenë prioritet edhe në të ardhmen në këto zona, që qyteti ta ketë një pamje më të bukur”, ka shkruar kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj.



OKB-ja: Numri i të varfërve ekstremë në botë mund të kalojë një miliard

NYU JORK, 12 QERSHOR - Dëmi ekonomik, i shkaktuar nga pandemia e koronavirusit, mund t'i fusë edhe 400 milionë njerëz në varfëri ekstreme, thuhet në raportin e ri të Kombeve të Bashkuara. Raporti, i publikuar të premten, paraqet disa skenarë për vlerësimin e ndikimit të koronavirusit në të ardhurat globale.

Në skenarin më të keq, humbje për 20 për qind e të ardhurave për kokë banori - numri i atyre që

jetojnë me 1.90 dollar në ditë mund të rritet në më shumë se një miliard. Për më shumë se 3.7 miliardë njerëz, mbi gjysmën e popullsisë së botës - të ardhurat, po ashtu, mund të bien nën 5.50 dollarë në ditë. "Perspektiva për më të varfrit në botë duket e zymtë nëse qeveritë nuk bëjnë më shumë për ta. Përparimi në zvogëlimin e varfërisë mund të kthehet 20 deri në 30 vjet prapa dhe ta bëjë ëndërr qëllimin e Kombeve të Bashkuara për t'i

dhënë fund kësaj dukurie", tha Andy Sumner, një nga autorët e raportit, raporton agjencia e lajmeve "Reuters".

Miliona njerëz në botë kanë humbur vendet e punës për shkak të pandemisë së koronavirusit e cila ka detyruar mijëra biznese t'i ndalojnë operimet.

Sëmundja Covid-19 ka prekur mbi 7.5 milionë njerëz në botë.

Prej tyre, mbi 3.5 milionë janë shëruar dhe mbi 422 000 kanë vdekur.



Përshkallëzohet situata në protestat në Liban

BEJRUT, 12 QERSHOR - Qindra persona kanë dalë nëpër rrugët e qyteteve të Libanit për t'i shfaqur pakënaqësitë e tyre teksa ky shtet përballet me rënie prej 70 përqindësh të vlerës së valutës që ka.

Rënia e vlerës së paundit libanez është regjistruar prej tetorit të vitit të kaluar.

Kryeministri i këtij shteti ka

kërkuar takim urgjent me kabinetin për ta diskutuar krizën ekonomike.

Protestat rreth kushteve të jetesës kanë nisur nga muaji tetor i 2019-s, ndërsa tani janë rikthyer pas lehtësimit të masave të vëna me qëllim të luftimit të koronavirusit të ri. Në kryeqytetin Bejrut dhe qytete të tjera protestuesit kanë bllokuar rrugët, kanë djegur

gomat dhe mbeturinat, derisa në qytetin verior, Tripoli, protestuesit kanë gjuajtur bomba naftë nëpër banka.

Shumë libanezë, që varen nga kursimet, tani janë duke u përballur me varfëri.

Koronavirusi i ri konsiderohet se ka përkeqësuar edhe më shumë situatën ekonomike në këtë shtet.



Ekonomia e Mbretërisë së Bashkuar tkurret për 20.4 për qind në prill

LONDËR, 12 QERSHOR - Ekonomia e Mbretërisë së Bashkuar është tkurur në nivel rekord përgjatë muajit prill 20.4 për qind si pasojë e masave të izolimit që synojnë të luftojnë me Covid-19. Kjo rënie mujore është vërejtur në të dhënat e publikuara nga Zyra Kombëtare e Statistikave.

Rënia në fjalë është tri herë më e madhe se rënia e shënuar përgjatë gjithë periudhës nga viti 2008 deri më 2009, kur bota ishte përballur me krizë ekonomike.

Zyra e Statistikave ka publikuar edhe të dhënat për tre muaj, nga shkurti në prill, të cilat kanë treguar rënie ekonomike për 10.4 për qind. "Rënia e bruto-prodhimit të brendshëm është më e madhe në historinë e Mbretërisë së Bashkuar, më shumë se tri herë më e madhe sesa muajin e kaluar dhe gati 10 herë më e madhe sesa para shpërthimit të Covid-19", ka thënë Jonathan Athow, zyrtari për statistika ekonomike në Zyrën Kombëtare të Statistikave.

"Në muajin prill ekonomia ka qenë rreth 25 për qind më e vogël sesa në muajin shkurt. Të gjitha fushat e ekonomisë janë goditur, baret, edukimi, shëndetësia, shitja e makinave, duke kontribuar në këtë rënie historike", ka thënë ai.

Pandemia Covid-19 është thënë të ketë ndikuar keq edhe në tregtinë britanike, pasi edhe aty janë raportuar rënie të mëdha në eksport dhe import të makinave, naftës, dhe punës artistike.



Koreja Veriore: ShBA-ja ka qasje kërcënuese ndaj Phenjanit

PENJANI, 12 QERSHOR - Ministri i Jashtëm verikorean, Ro Son Gwon, ka thënë se politikat amerikane ndaj Phenjanit vërtojnë se Uashingtoni vazhdon të jetë kërcënim për Korenë Veriore, andaj do të zhvillojë më shumë armë ushtarake për të luftuar këtë rrezik.

Ky zyrtar ka thënë, përmes një

deklarate të publikuar nga agjencia shtetërore e lajmeve, KCNA, se lidhja personale që presidenti amerikan Donald Trump ka krijuar me liderin verikorean, Kim Jong-Un, duket se është fokusuar vetëm në fitoren e pikëve politike dhe se nuk ka shumë mundësi se do të rezultojë me ndonjë pikë kyçe



diplomatike.

Kjo deklaratë ka ardhur në përvjetorin e dytë të takimit të parë

në mes të Kimit dhe Trumpit, në të cilin presidenti amerikan i ka kërkuar Koresë Veriore heqjen dorë nga armët bërthamore, në këmbim të lirimit të sanksioneve.

Trump ka folur me tone të ngrohta për shoqërinë me Kimin dhe të dy liderët patën bërë deklarata publike për ta treguar suksesin e

arritur në bisedimet rreth çarmatimit të Gadishullit Korean.

Megjithatë, deri më tani është arritur pak përparim. Uashingtoni i kërkon Phenjanit që të heqë dorë nga armët bërthamore para se të largohen sanksionet, derisa Koreja Veriore kërkon që sanksionet të hiqen fillimisht.

"Twitter"-i fshin mbi 170 000 llogari pro-Kinës

NYU JORK, 12 QERSHOR - Gjiganti "Twitter" ka fshirë më shumë se 170 000 llogari të cilat ka thënë se kanë qenë të lidhura me operacione për shpërndarje të mesazheve pro-Kinës. Disa prej këtyre postimeve kanë qenë

rreth shpërthimit të koronavirusit, ka thënë ky rrjet social. Kjo kompani ka thënë se "një rrjet kyç", i 23 750 llogarive aktive janë fshirë, bashkë me 150 000 llogari të tjera "përforcuese".

"Twitter", po ashtu, ka thënë se

ka mbyllur më shumë se 1 000 llogari të dezinformimit me bazë në Rusi. Kjo kompani ka thënë se rrjeti kinez, me bazë në Kinë, ka pasur lidhje me operacione paraprake shtetërore, të cilat janë bërë të ditura përmes platfor-

mave të tjera "Facebook" dhe "YouTube".

Ky rrjet ka shtyrë përpara mesazhe për situatën politike në Hong Kong.

Zyrtarët e "Twitter"-it kanë thënë se kanë qenë duke "analizuar në



detaje informacionet e kaluara që kanë qenë të koordinuara nga Kina".



Mirela Oktrova, fotot unike dhe ditari që u shkrua në netët e luftës së Kosovës, pas raportimit për Europën

Mirela Oktrova, gazetarka që 20 vjet më parë raportoi për Europën nga kampet e refugjatëve në Maqedoni dhe hyri me forcat e NATO-s në Kosovë, është vlerësuar nga Shoqata e Botuesve të Kosovës në kuadër të Panairit të Librit, Prishtinë 2019, me Çmimin e Publicistikës. “55 ditë” quhet albumi-ditar, botimet “Onufri”, 20 vjet pas çlirimit të Kosovës, si dokumentim dhe dëshmi e së shkuarës së afërt jo vetëm përmes rrëfimit, por duke u shoqëruar me foto unike nga zona e krizës, kur çdo ditë me mijëra shqiptarë të Kosovës evakuoheshin drejt Perëndimit

Intervistoi: Violeta MURATI

Libri juaj, apo më mirë albumi-ditar nga lufta e Kosovës, është vlerësuar në Panairin e Librit 2019, në Prishtinë, me Çmimin e Publicistikës. Para se t’ju pyesja konkretisht rreth këtij projekti, doja të dija se si e shihni rolin e medias, sidomos raportimet nga zonat e krizës apo nga fronti i luftës... Në Shqipëri, me sa dimë, ju jeni e vetmja gazetare që e keni bërë këtë.

Në periudhën së cilës i referohem në ditarin tim, kam qenë gazetarka e vetme shqiptare në

zonën e krizës dhe e para gazetare që më 12 qershor 1999 hyri me trupat e NATO-s në Kosovë. Nisur nga përvoja ime e gjatë si gazetare dhe veçanërisht nga përvoja si reportere lufte, them se profesioni i gazetarit, pavarësisht se në kohë lufte apo paqeje, është baras me përgjegjësi. Po nëse në kohë paqeje informimi duhet të jetë i përgjegjshëm, pasi prej tij varet orientimi shoqëror i secilit prej individëve që shërbehet me të, në kohë lufte nga përgjegjësia e informimit varet jeta e gjithsecilit që e merr këtë informacion. Nuk marr dot përsipër të them me siguri nëse jam e vetmja që kam qenë në një pozicion të tillë,

ndonëse në dijeninë time po. Por për mua, më shumë rëndësi se të qenit në zonën e luftës, kanë rëndësi mësimet që gjithsecili nxjerr prej një përvoje të tillë. Dhe sipas meje, veçanërisht për një treg informacioni si yni, është jetike të mos kesh nevojë të kesh qenë në luftë për t’u bërë i përgjegjshëm në paqe...

Ditari ofron informacion të dorës së parë, me një fokus të përcaktuar, ngjarjet e të cilit nisin në pashkën e vitit 1999, kur bota u përball me një eksod masiv të shqiptarëve të Kosovës... Ka një histori vendimi që morët për t’u nisur në zonën e krizës në Maqedoni?

Duke qenë se punoja për seksionin shqip të radios Dojçe Vele, pra për një redaksi lajmesh që informonte disa herë në ditë për rajonin, isha gjithsesi e lidhur profesionalisht dhe emocionalisht shumë ngushtë me ngjarjet. Por në epiqendër të tyre më vuri një zhvillim i një natyre tjetër... Të dielën e pashkëve nga Ministria e Brendshme e RFGJ-së më ofruan të shoqëroj si eksperte për rajonin misionin e posaçëm që do të evakuonte të shpërngulurit e Kosovës nga Maqedonia në Gjermani. Misioni gjerman – i pari i këtij lloji – synonte të bëhej model për vendet e tjera perëndimore. Nuk hezitova të

pranoja, me gjithë përgjegjësinë ndaj vajzës dhe prindërve, por nuk mund të bëja ndryshe... Nuk ishte as turizëm lufte dhe as aventurizëm, por thjesht nuk munda të refuzoja... Drama njerëzore që unë, si gazetare e lidhur shumë ngushtë me rajonin, e dija se si kulmonte çdo ditë e më frikshëm në Kosovë, nuk më linte të bëja sehir...

“E Premte e Madhe, 2 prill 1999...” dhe më pas “Misioni i parë: Pashkë në Bllacë...” Kështu e nisni ditarin... Ka ndonjë prapamendim, apo është kjo rastësi për ju? Në çfarë besuat në ato momente?

Fillimi i ditarit dhe përjetimeve të paraqitura në të është i diktuar nga historiku i ngjarjeve apo nga aktualiteti i dikurshëm. Ndonëse shpesh eksodit kosovar të vitit 1999 i vihet epiteti “biblik”, jo gjithkush e di se ishte pikërisht e Premtja e Madhe e Shenjtë e Pashkës 1999 dita që shënoi kulmin e emergjencës së refugjatëve në brezin asnjës të pikës kufitare të Bllacës dhe e Diela e Pashkëve ajo që sensibilizoi opinionin ndërkombëtar për dramën humanitare të shqiptarëve të Kosovës, që kishin kohë që endeshin brenda Kosovës, por që atë ditë mbërritën me qindra mijëra në kufi, duke u bërë më në fund të perceptueshëm për

botën. Në momentin kur unë u bëra pjesë e misionit, besoja se njerëzve u duhej ardhur në ndihmë me çdo kusht dhe se askush të cilit i jepej mundësia për ta bërë këtë, nuk mund të shmangej, pavarësisht pasojave që në atë moment nuk ishin të parashikueshme.

Ju raportoni për Dojçe Vele-n, RTSH-në dhe media të tjera gjermane. Ndërsa raportimi kërkon një gjendje “të akullt” apo neutral për të komunikuar vetëm faktet, të vërtetën, sa e mundur është kjo, kur raportohet nga zona e krizës apo fronti i luftës, kur pamjet tragjike janë përballë. A kujtoni ndonjë episod lidhur me këtë?

Fatmirësisht, dita dhe nata ime e punës ishte e organizuar në mënyrë të tillë, që më jepte mundësinë të ndaja veprimtarinë time në mbështetje të të shpërngulurve, çka ndodhte në kuadrin e misionit gjerman për evakuimin e tyre nga Maqedonia, nga pozicioni i reporterit të fokusuar te faktet. Ndonëse angazhimi im parësor në rajon kishte të bënte me misionin e evakuimit dhe angazhimin tim si eksperte dhe përkthyes në kuadrin e procedurave përkatëse, raportoja mesatarisht gjashtë herë në ditë live për mediat audiovizive gjermane dhe shqiptare. Të gjitha

emocionet dhe mbresat e tjera që nuk arrija t'i përpunoja dot gjatë ditës, mundohesha t'i hidhja në ditarin që mbaja pasditeve dhe mbrëmjeve, si një mënyrë për t'u "larë" borxhin të gjithë atyre që nuk kishin gjetur dot vend në raportimet e mia ditore. Episodi më mbresëlënës përkitazi punës sime si reportere i takon një dite kur, ndryshe nga herët e tjera kur unë, për të shmangur ndërprerjen e linjës dhe ndërhyrjen e zhurmave, informoja nga automjetet e grupit, për shkaqe logjistike u detyrova të raportoja direkt nga kampi, ku prej pak ditësh ishte instaluar një altoparlant, nëpërmjet të cilit banorët e kampit mund të ndiqnin programet e Dojçe Vele-s në shqip.

Kështu, tek informoja për programin e mesditës, u bëra papritur e ndërjegjshme se zëri që momentalisht vinte nga altoparlanti, ishte zëri im, dhe reagimet e atyre që dëgjonin kishin të bënin me ato që po thosha unë. Tek shihja me sa vëmendje më dëgjonin, desh u stepa dhe efekti i atyre që po thosha nisi të më trembë. Ndikimi i medias te publiku i vet nuk ishte i panjohur për mua – po deri në atë çast e kisha njohur thjesht teorikisht e profesionalisht, pa e provuar praktikisht. Të paktën jo në këtë formë dhe me këtë mprehtësi. Se vetëm në atë çast pashë me sytë e mi se si nga çdo fjalë që unë thosha, varej jeta e atyre që më dëgjonin... nëse unë informoja që mbrëmjen e shkuar kishte kaluar kufirin edhe një kontingjent i ri të dëbuarish, secilit prej tyre i ringjallej shpresa se në të mund ishte nëna, babai, vëllai, motra, të dashurit e vet, të humbur prej muajsh... nëse njoftoja se kufiri ishte mbyllur, kjo për ta do të thoshte ankth i tmerrshëm për gjithë ç'mund t'u ndodhte atyre që kishin mbetur të mbyllur në anën e vdekjes... po kështu, nëse flisja për bombardime, për evacuime, për masa mbështetëse apo për ndihma nga komuniteti ndërkombëtar... Ndërsa flisja dhe ndiqja reagimin e dëgjuesve të mi, për herë të parë mendova se lufta dhe krizat me sfond ekzistencial janë përvoja nga duhet të kalojë të paktën një herë në jetë çdo gazetar, për të kuptuar se nga pena, fjala dhe reagimet e tij varet jeta e të tjerëve, aq më shumë në anët tona, ku gazetaria nuk është sfidë përgjegjësie.

A është ky album-ditar një plan paraprak? Pse gjithë kjo distancë kohe dhe pritjeje për të parë dritën e botimit?

Ideja për publikimin e këtyre materialeve ka "mushën" e vetë dëshmiteve që këto materiale zbulojnë. Edhe vendimi për të pritur gjithashtu. Ngjarje si këto shënjojnë kombin, shoqëritë, mediat, njerëzit... Në një drejtim a në një tjetër. Fatkeqësisht, më shpesh në një tjetër nga ai i pritshmi... Në këndvështrimin

tim, shoqëria jonë dhe media, si pjesë e saj, janë tejet problematike në mënyrën se si raportohen me ngjarje të këtij lloji. Pasi marrëdhënia me to është e pandarë nga përdorja apo më saktë nga keqpërdorja e tyre – për karrierë, për protagonizëm apo për pushtet. Ndaj unë me qëllim vendosa të prisja. Për të ndenjtur në mënyrë të ndërjegjshme larg këtij trendi, paçka se ideja jetonte me mua në gjithë këto vite. Dhe prita... Derisa të gjitha dëshmitë e tjera, jo të drejtpërdrejta dhe mbese edhe jo autentike, u konsumuan, protagonizmat e të gjitha llojeve verifikuan synimet, duke e justifikuar vetveten ose jo, dhe interesat – të paktën ato afatshkurtra dhe afatmesme – shteruan. Atëherë mendova se kishte kaluar "koha e rrekjes së madhe për lavdi" dhe u kishte ardhur radha dëshmitëve autentike dhe së vërtetës, së vërtetës së jetuar me të vërtetë.

Kur para rreth shtatë vjetësh hapa në Tiranë ekspozitën "Fate lufte", e kisha vendosur me

saj dhe një tjetër jubile, i lidhur drejtpërdrejt me këto dëshmi, u shënua këto ditë kur unë, më në fund, arrita ta sjell librin në Prishtinë, duke plotësuar kështu jo vetëm premtimin që i kisha dhënë vetes, por dhe detyrimin ndaj Kosovës që ushqeu mbresat dhe faktet që libri përmban.

Fotot, pa dyshim, janë mbresëlënëse, tronditëse... Si nisët t'i bënit ato fotografi? A ka foto ose pjesë rrëfimi të lëna jashtë, apo gjithçka është e përfshirë në "55 ditë"?

Fotografitë që shoqërojnë rrëfimin, nuk janë fotografi artistike, madje as produkt i një plani paraprak. Edhe sot nuk jam në gjendje të shpjegoj se si nisa t'i bëja ato fotografi. Në mendje më ka mbetur vetëm dëshira për të mos u "ndarë" prej portreteve që ato fiksojnë. Ndaj këto foto-dëshmi janë shkrepur shpejt, me ndjesinë e momentit, dhe fillimisht nga larg, për të mos lënduar të fotografuarit dhe për të mos prodhuar ndjesinë se vuajtja e tyre po përdoret. Derisa



ata – me të parë aparatën fotografik – zunë vetë të afrohen dhe të kërkojnë të fotografohen. Disa për të fiksuar, qoftë dhe virtualisht, ekzistencën prej muajsh të pasigurt, të tjerë për të lënë gjurmë jete në një rrugëtim, ku jo një herë ishin ndier të humbur. Ndaj fotot e mia fiksojnë të moshuar që i ktheheshin aparatit me ndjesinë e ndarjes nga jeta, fëmijë, prindërit apo të afërmit e të cilëve më shtynin t'u fiksoja fytyrat si dëshmi ekzistence, dhe cilindo tjetër që "takimin" me aparatën fotografik e shihte si vëmendje dhe mundësi për të rimarrë fytyrë në një veçim sado të shkurtër nga masa shumëvujtëse që e shndërronte në numër. Fiksimi i identiteteve në celuloid më shkaktoi, megjithatë, një lloj stepjeje etike, veçanërisht vitet e ushtrimit të profesionit në Gjermani do më kishin shtyrë në çdo rast tjetër të tentoja të dokumentoja miratimin e "heronjve" të mi për t'u fotografuar, por në kushtet kur

kufiri kalohej me një vullë në dorë dhe njerëzit e konsideronin foton si amanet, plotësimin e vullnetit të tyre të fundit në tokën, që po linin, e pashë si detyrim. Një detyrim të plotësuar vetëm përgjysmë deri ditën e botimit të këtij libri, kur dëshmia e tyre të arrijë lexuesin.

Fotot janë, në fakt, shumë më tepër se ato të paraqitura në këtë album – ato janë afro 500. Po unë këtu kam paraqitur ato që flasin më shumë, ndërkohë që materialin i shkruar është ofruar në mënyrë shteruese.

Ç'domethënie ka fotografi e kopertinës dhe të tjera foto në album, ku shihen vula dhe numra identifikimi mbi duar refugjatësh, çka ngjall trishtim, të kujton holokaustin, por, në fakt, ka shërbyer për të shpëtuar dhe jo për të shfarosur jetë. Ju ishit e angazhuar drejtpërdrejt në këtë "numërim"? Si e shihnit këtë procedurë?

Në mungesë të dokumenteve të identifikimit dhe vizës, secili prej të shpërngulurve merr në dorë

Përmes fotove ju sillni pamje autentike të dramës së të shpërngulurve nga Kosova. Me çfarë u përballët më pas? Çfarë keni ndier dhe perceptuar nga të gjitha këto trazime?

Misioni ynë evakoi 15 mijë vetë drejt Gjermanisë. Kur ktheva kurrizin për të ikur, duke lënë pas gjithë atë anonimat të madh vuajtjes dhe sakrificash, ndjeva se doja t'i mbaja mend të gjithë... të gjithë ata që, kur ngjarjet e ditës mbysnin qetësinë e natës, as më largoheshin dhe as u largohesha dot nga mendja dhe sytë. Ato fate të nëpërkëmbura nga lufta, të mpakura nga drama humanitare, të lëna pas dore nga lajmet e frontit, statistikat dhe strategjitë, e dija se do të vazhdonin të më emociononin sa herë t'u rikthehesha shënimeve të atyre kohëve, kur natën e shkurtonte halli dhe gjumin e zbonin mbresat. Pas kisha lënë një pjesë të shpirtit tim, të ngjizur në mijëra emra dhe fate që s'më ndaheshin, duke më rithënë për herë të 15001-të se lufta është dhimbja më e madhe që njerëzimi mund t'i shkaktojë vetvetes, por edhe mësimi më i madh që jeta mund t'i japë njerëzimit! Dhëntë Zoti, të mos përjetojmë luftën, për të mësuar të vlerësojmë paqen! Me këto mendime dhe mbresa – herë më intensive dhe herë më pak – kam jetuar deri sot, kur për herë të parë kam ndjesinë se u kam "larë atyre borxhin" që u kisha për t'u rikthyer kujtimet dhe mbresat me të cilat më ngarkuan atëherë.

Në gjithë këtë histori rrëfimi Shqipëria nuk është në fokus. Përse?

Drama e të shpërngulurve nga Kosova, pa dyshim, është shumë më e madhe, shumë më e gjerë dhe shumë më e thellë nga sa më panë sytë e më dëgjuan veshët mua në Maqedoni dhe pjesërisht në Kosovë. Një nga kapitujt më tronditës të saj – nëse jo më tronditësi – është Golgota shqiptare e qindra mijëra të dëbuarve kosovarë dhe po aq të pakamurve shqiptarë që ndanë me ta gjithë ç'kishin e ç'nuk kishin.

Po Shqipëria nuk është në

E jashtëzakonshme

Misteri i liqenit në Indi, pas 50 mijë vjetëve ndërron ngjyrë

Një liqen në Indi mbi 50 mijë vjet i vjetër ka marrë ngjyrë vjollcë, kurse ekspertët ende nuk kanë shpjegim se pse ka ndodhur një gjë e tillë, shkruan "CNN". Liqeni Lonar në shtetin Maharashtra në mënyrë të befasishme ka ndërruar ngjyrë disa ditë më parë, duke i habitur edhe banorët që jetojnë përreth liqenit. Siç raporton "CNN", ekspertët konsiderojnë se shkak i kësaj



mund të jetë shtimi i ujit të njelmët, përqindja e algave apo kombinimi i këtyre dy faktorëve siç ka ndodhur me liqenin e madh të njelmët në Utah apo me liqenin Hillier në Australi.

BARSOLETA E DITËS



Një grua po i ankohej mjekut:
- Djali im është mjaft i sëmurë. Ka dhimbje të forta në bark.
- Çfarë ka ngrënë?
- Njëfarë fiqi tha, e ai ishte i mbushur me miza.
- Jepi ilaç mizash dhe qetësohet.



Në Kino ABC nuk ka shfaqje

Vonohet 'Deadpool 3', fajësohet 'Marvel'

Krijuesi i filmave "Deadpool", Rob Liefeld, e ka fajësuar studion "Marvel" për vonimin e fillimit të punës rreth vazhdim-it të tretë të këtij projekti. "Deadpool 2" ishte lansuar në vitin 2018, derisa në dhjetor të vitit të kaluar protagonist i këtij filmi, Ryan Reynolds, e kishte konfirmuar lajmin se filmi i tretë ishte në realizim e sipër nga studioja "Marvel". Duke folur për vazhdimin e tretë të këtij projekti, të cilin definitivisht e kishte paralaj-

jmëruar për fillim të vitit 2019, krijuesi Rob Liefeld e fajësoi studion e famshme "Marvel" për vonesat e vazhdueshme. "Marvel" është përfshirë në realizimin e filmave "Deadpool", pasi studioja prapa realizimit të tyre, "Fox", u ble nga kompania "Disney", transmeton Koha. Ndërkaq, ylli hollywoodian, Ryan Reynolds citohet të ketë thënë: "Po, bashkë me tërë ekipin aktualisht jemi duke punuar rreth këtij filmi".

DEADPOOL



FOTO E DITES



Në oborrin e Kuvendit të Kosovës, në Ditën e Çlirimit, janë mbjellë 1 133 lule për t'i përkujtuar 1 133 fëmijët e vrarë gjatë luftës së fundit në Kosovë.

E rrallë

Avioni i kohës së Luftës së Ftohtë që ende mban rekordin e shpejtësisë



Gjatë kohës së Luftës së Ftohtë kompania amerikane "Lockheed" krijoi modelin SR-71 Blackbird i cili mund të fluturonte më shpejt se çdo mjet tjetër dhe sot pas 55 vjetësh ai vazhdon ta mbajë rekordin. Mjeti u krijua në fshehtësi në vitet 1960 për të luftuar në kufijtë e hapësirës i cili mund të hynte në territor armik pa u rrëzuar e madje pa u dalluar, në kohën kur

nuk kishte satelitë apo dronë. Më 1976, SR-71 vendosi rekordin e shpejtësisë që qëndron ende: fluturoi në lartësi 30 000 metra me shpejtësi prej 2 193.2 milje në orë, ose ndryshe Mach 3.3. SR-71 u përdor për herë të fundit nga NASA në 1999 për funksione kërkimore. Prej atëherë Blackbirdat e mbetur kanë gjetur vendin e tyre në muze.

 <p>DASHI Do të ndiheni apatik dhe më pak të shoqërueshëm se zakonisht. Këshillohet që të keni një fleksibilitet më të madh në pranimin e këndvështrimit të të tjerëve.</p>	 <p>DEMI Do të dëshironi që të keni një punë të re. Përreth për të gjallëruar pak ditën, por jo të gjithë do t'ju duken të këndshëm në shikim të parë.</p>	 <p>BINJAKËT Hutimet do t'ju zhdukin idetë interesante që keni në kokë. Të tërhequr nga emocionet, do të bëni gabime dhe do ta humbisni sensin e masës.</p>	 <p>GAFORRJA Mund të mbështeteni në një ditë fitimprurëse dhe paqësore. Do të ketë edhe mundësi të vogla, por të çmuara për t'i rritur fitimet.</p>	 <p>LUANI Për të dalë nga dembelizmi që ju ka kapur këtë kohë, përpuni që të ndërtoni diçka për të ardhmen dhe lëreni veten të udhëhiqet nga instinkti.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Gjithçka duket e largët dhe e ftohtë.. Mos e rëndoni shumë stomakun, hani ushqime të lehta dhe avash, pasi ju ndihmojë ta shijoni ushqimin.</p>
 <p>PESHORJA Yjet do t'ju bëjnë të lumtur. Entuziazmi do të ndizet përballë risive që do ta stimulojnë kureshtjen tuaj.</p>	 <p>AKREPI Pasi ta përfundoni punën, nuk do të dëshironi të shkoni në shtëpi, do të keni shumë vull dhe dëshirë që të punoni ende.</p>	 <p>SHIGJETARI Nëse duhet të merrni pjesë në një aheng, shkoni me frymën e duhur dhe përpuni që të mos jeni të ngurtë. Nuk është koha për aventura.</p>	 <p>BRICJAPI Dikush do të shikojë suksesin tuaj me shumë zilië. Lëreni të xhelozojë, më mirë dikush që të ka zili sesa të bëhet mashtrues.</p>	 <p>UJORI Falë një qielli të favorshëm ju do të jeni në gjendjen e duhur shpirtërore për t'u përballur dhe për të kapërcyer çdo problem me qetësi.</p>	 <p>PESHQIT Organizoni një udhëtim me partnerin tuaj në një vend romantik. Bëjini një mijë fotografi dhe argëtohuni së bashku.</p>

Sekretet e Dianës përpara se të bëhej princeshë



Nga puna e saj si filantropë e deri te stili i saj i veshjes, Princeshë Diana ka frymëzuar modën edhe në ditët e sotme. Por, para ditëve të saj mbretërore ajo ishte thjesht Diana Spencer, një vajzë e re që adhuronte motrën e saj më të madhe.

Ajo e mbushte shtratin me kafshë duke lënë pak hapësirë për veten. Bright Side bëri një seleksionim të fotografive të Lady Di, të cilat vështirë se janë parë më herët, duke treguar se si ishte jeta e saj larg qendrës së vëmendjes.

Shkrimtarja e Harry Potterit rrëfen për abuzimin seksual



Autorja e "Harry Potter", JK Rowling, ka publikuar një ese ku flet për herë të parë për dhunën dhe abuzimin seksual në jetën e saj, reagim ky që vjen pas kritikave që mori për komentet transfbike që bëri në media sociale. Autorja zbuloi se ajo ishte "një e mbijetuar nga dhuna dhe abuzimi seksual", duke përmendur këtë kra-

has besimit të saj në lirinë e fjalës dhe përvojës si mësuese, si arsye prapa pozicionit të saj. "Më kanë lënë një në një vend shumë të errët brenda kokës time, si kujtime për një sulm seksual që pësova në vitet '20. Ai sulm ndodhi në një kohë dhe në një hapësirë ku unë isha e pambrojtur dhe një njeri kapitalizoi në këtë mundësi", ka thënë Rowling.



"Waka Waka" e Shakiras feston 10-vjetorin

Ishte vera e vitit 2010 dhe kënga 'Waka Waka' e Shakiras ngjiste klasifikimet në mbarë botën. Kënga verore e Shakiras u bë edhe himni zyrtar i Botërorit të Futbollit të Afrikës së Jugut 2020, ku është kënduar live në ceremoninë e hapjes dhe të

mbylljes të kampionatit të futbollit.


Kënga e shkruar nga vetë Shakira bazohet në këngën kameruneze "Zangalewa" të grupit Golden Sounds të 1986-s, nga ku është marrë pothuajse e gjithë 'Waka Waka' që do të thotë 'Ecni ecni'.

Koncerti i Malumës shtyhet sërish, kësaj radhe për në qershor të vitit 2021



Koncerti i këngëtarit me famë botërore, Maluma, i paraparë të mbahej në mars të këtij viti, ishte shtyrë për në muajin shtator. Më saktësisht, koncerti ishte paraparë të mbahej më 6 shtator të këtij viti në sheshin "Nënë Tereza". Mirëpo për shkak të

pandemisë globale Covid-19, koncerti është shtyrë edhe një herë dhe kësaj radhe për një datë të caktuar në vitin tjetër. Në një njoftim të bërë në rrjetet sociale, organizatorët kanë lajmëruar se data e re për koncertin e Malumës do të jetë 24 qershor 2021.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

Ballkani dështon sërish, Feronikeli vazhdon të fitojë

Skuadra e Ballkanit është ndalur në barazim nga Flamurtari, kurse Feronikeli ka fituar në përballjen me Dukagjinin. Sot (e shtunë), me fillim nga ora 17:00, zhvillohen dy ndeshje në Superligë, në të cilat do të përballen Vushtrria - Prishtina dhe Llapi - Drenica



IPKO SUPERLIGA - JAVA E 24-t

Dukagjini - Feronikeli 0-2
Flamurtari - Ballkani 0-0

Të shtunën takohen:
17:00 Vushtrria - Prishtina
17:00 Llapi - Drenica

Të dielën takohen:
17:00 Trepça '89 - Drita
17:00 Ferizaj - Gjilani

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Skuadra më e mirë në Kosovë deri para pushimit, për shkak të pandemisë Covid-19, Ballkani nga Suhareka, e ka regjistruar edhe një tjetër dështim në Superligë. Pas barazimit kundër Drenicës (0-0) në ndeshjen e kaluar, Ballkani ka regjistruar rezultat identik edhe ndaj Flamurtarit në kryeqytet. Skuadra nga Suhareka ishte më e mirë, por nuk arriti ta shënojë golin e tri pikëve. Rastin më të mirë për gol e lëshoi Blend Baftiu, i cili në fund të ndeshjes e qëlloi

tranzverzalen. Pas kësaj ndeshje, Ballkani është në vendin e dytë me 46 pikë, kurse Flamurtari është në pozitën e tetë me 28 pikë. Në ndeshjen tjetër Feronikeli dëshmoi edhe një herë formë të mirë, pasi e fitoi edhe ndeshjen e dytë pas kthimit në futboll pas pushimit nga pandemia.

Skuadra kampione në fuqi arriti të regjistrojë fitore ndaj Dukagjinit (0-1). Në pjesën e parë gola nuk pati, kurse në pjesën e dytë skuadra mysafire arriti të shënojë dy gola. Mevlan Zeka shënoi në minutën e 47, kurse rezultatit final e vulosi Jean Da Silva në minutat e fundit të

ndeshjes. Pas këtyre tri pikëve, "Nikli" ka grumbulluar 40 pikë, derisa Dukagjini mbetet në kuotën e 10 pikëve. Në kuadër të javës së 24-t sot (e shtunë) zhvillohen dy ndeshjet e radhës. Vushtrria e pret Prishtinën nga ora 17:00, në ndeshjen ku

kryeqytetasit llogaritën favoritë absolutë për faktin se kanë skuadër më të mirë dhe janë në garë për titull. Vushtrriasit janë të parafundit në tabelë dhe vështirë e kanë ta sigurojnë mbetjen në elitë edhe për edicionin e ardhshëm. Ndeshja tjetër që

zhvillohet në stadiumin "Zahir Pajaziti" në Podujevë mes Llapit dhe Drenicës pritet të jetë më interesante. Skuadra e Llapit synon fitoren në këtë ndeshje, sepse pretendon të ngrehet në njërin prej pozitave të para dhe në fund ta sigurojë pjesëmarrjen në garat evropiane, por kjo ndeshje nuk do të jetë aspak e lehtë, pasi kuqezinjtë nga Skenderaj në ndeshjen e kaluar i morën pikë edhe skuadrës së Ballkanit.

FSUK-ja dhe FShSU-ja, marrëveshje për gjallërimin e jetës sportive

DURRËS, 12 QERSHOR - Në ambientet e Universitetit "Aleksandër Moisiu" në Durrës, Federata Shqiptare e Sportit Universitar (FShSU) dhe homologia e saj në Kosovë (FSUK) kanë nënshkruar të premtën një marrëveshje bashkëpunimi për gjallërimin e jetës sportive universitare në Shqipëri dhe Kosovë. Marrëveshja është nënshkruar nga presidenti i FShSU-së, Besnik Veliu dhe presidenti i FSUK-së, Musa Selimi. Në fjalën e tij përshëndetëse Veliu e cilësoi marrëveshjen historike për integrimin e studentëve në sportin universitar dhe të rëndësishme për ndërgjegjësimin e institucioneve



respektive në këtë fushë. "Ende pa u mbushur dy vjet nga krijimi i federatave tona, Shqipëria ka fituar të drejtën e organizimit të Kampionatit Evropian Universitar të Futbollit, ndërsa Kosova Kampionatin Botëror

Universitar në Hendboll", ka thënë Veliu. Ndërsa presidenti i FSUK-së, Musa Selimi, pasi falënderoi Universitetin e Durrësit për mikpritjen e ngrohtë, ka thënë se bashkëpunimi sportiv mes dy

vendeve ka qenë një ëndërr e kahershme që po bëhet realitet. "Me nënshkrimin e kësaj marrëveshjeje për organizimin e aktiviteteve të përbashkëta universitare, ne përcjellim mesazhin e organizimit të përbashkët edhe të ligave më të mëdha", ka thënë Selimi. Sipas marrëveshjes, federatat do të bashkëpunojnë për organizimin e veprimtarive të përbashkëta sportive studentore të arsimit të lartë brenda territorit të Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës, me vëmendje të veçantë në kampionatet kombëtare universitare. Po ashtu, palët u zotuan për ta përfaqësuar denjësisht sportin universitar në

Shqipëri e Kosovë në aktivitetet ndërkombëtare të organizuara nga Federata Ndërkombëtare e Sportit Universitar (FISU), Shoqata Evropiane e Sportit Universitar (EUSA) etj. Rëndësi iu kushtua edhe kërkimit shkencor, me synim hartimin cilësor të programeve të sportit universitar si dhe zhvillimin e formave të reja sportive në Shqipëri dhe Kosovë përmes aplikimit të praktikave më të mira ndërkombëtare. Të dyja federatat kanë qëllim aktivizimin fizik të studentëve si element të rëndësishëm për garantimin e shëndetit psikofizik të tyre, largimin nga veset, motivimin si dhe zhvillimin e kulturës sportive në vend.

Përzgjedhësi Marmarinos ligjëron para trajnerëve të Kosovës

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Përzgjedhësi i Kosovës në basketboll, Christos Marmarinos, do të ligjërojë para trajnerëve të Kosovës me anë të një videokonferencë. Kjo videokonferencë do të mbahet të dielën më 14 qershor nga ora 19:00, në të cilën pritet të mar-

rin pjesë shumë trajnerë vendorë. "Tema e ligjëritimit do të jetë sulmi tranzicional dhe sulmi i hershëm, kurse trajnerët mund të interesohen edhe për tema të tjera me interes për basketboll. Ligjëratat është shumë e mirëseardhur për trajnerët vendorë, sidomos në këtë kohë

pandemie kur janë pezulluar aktivitetet sportive për shkak të pandemisë Covid-19", thuhet në njoftimin e FBK-së. Kohë më parë Marmarinos ka ligjëruar edhe para gjyqtarëve të Kosovës në lidhje me raportin trajner-gjyqtar. Ai është shprehur i gatshëm ta

ndihmojë basketbollin në çfarëdo forme derisa në muajin gusht do të jetë në Kosovë për ta udhëhequr grumbullimin e Përfaqësueses A. Christos Marmarinos ka drejtuar në dy ndeshje Kosovën dhe ka shënuar dy fitore ndaj Islandës dhe Luksemburgut.



Rrahman Haradini kërkon që Prishtina të luftojë për titull dhe Kupë

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Skuadrën e Prishtinës në seancën stërvitore të premten e ka vizituar një prej dy aksionarëve më të mëdhenj të klubit, Rrahman Haradini, i cili me vendbanim ndodhet në Zvicër dhe

vetëm tani pas lehtësimit të masave pas pandemisë, ka vizituar futbollistët "bardhekaltër". "Qëndrimi i Haradinit ishte i shkurtër dhe i qartë, qëndron prapa futbollistëve fuqishëm dhe iu është falënderues që skuadra

ka përparuar kaq shumë edhe pse jemi gjendur në kushtet e pandemisë. Konstatimi i përgjithshëm ishte se skuadra duhet luftuar deri në fund për qëllimin që ka para vetes, titullin kampion dhe fitimin

e trofeut të Kupës", thuhet në njoftimin e FC Prishtina. Prishtina është në garë për titull, pasi është vetëm dy pikë pas skuadrës kryesuese, derisa ndeshjen e parë të gjysmëfinale të Kupës e fitoi kundër Drenicës (3-0).



Sot rifillojnë garat në hendboll



PRISHTINË, 12 QERSHOR - Hendbolli, më në fund, po kthehet në Kosovë pas pushimit të gjatë për shkak të pandemisë Covid-19. Sot (e shtunë) janë ndeshjet e para gjysmëfinale të plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll (meshkujt). Aktivitetet e hendbollit ishin pezulluar më 13 mars për shkak të paraqitjes së koronavirusit. Vendimi i FHK-së ishte në përputhje me vendimin e Qeverisë së Kosovës. Prej fillimit të qershorit skuadrat janë kthyer në stërvitje, ndërsa janë munduar të përgatiten sa më mirë për plejof dhe për turneun final të Kupës. Pushimi i gjatë natyrisht se ka ndikimin e vet por, megjithatë, gara për titull pritet të jetë interesante.

Kampionia aktual, Besa Famgas, e pret Kastriotin e Ferizajt nga ora 20:00. Ndeshja luhet në palestrën "Karagaçi", pa praninë e shikuesve. Federata dhe klubet kanë marrë masat për t'i respektuar kërkesat që kanë të

bëjnë me higjienë dhe shëndet. FHK-ja ka formuar task-forcë për përballje me Covid-19, ndërsa klubet kanë bërë përgatitjet e duhura për ta vazhduar garën në rrethana të reja. Nga ora 17:00 luhet ndeshja në mes të Prishtinës dhe Trepçës. Ndeshjet

e kthimit zhvillohen në Ferizaj e në Mitrovicë. Në momentin kur u ndërpre kampionati, Besa Famgas ishte në vend të parë me 36 pikë nga 18 xhiro. Prishtina ishte e dyta me 32 pikë, Trepça e treta me 26 pikë dhe Kastrioti i katërti me 22 pikë.

Rikthehet edhe Superliga e femrave

Sot luhen edhe ndeshjet e para gjysmëfinale të plejofit në Superligën e Kosovës në hendboll në konkurrencë të femrave. Përkundër pushimit të gjatë për shkak të koronavirusit, shpresohet se gara për titull të kampionit do të jetë e mirë. Ndeshjet e para gjysmëfinale luhen në Ferizaj e Prishtinë. Ferizaj e Vushtrria takohen nga ora 19:30, kurse Prishtina e Istogu nga ora

14:30. Çiftet gjysmëfinale janë përcaktuar me short. Në momentin e ndërprerjes së kampionatit, Istogu, Vushtrria, Prishtina e Ferizaj kishin nga 22 pikë e nga 13 ndeshje të luajtura. Për këtë u vendos që çiftet gjysmëfinale të përcaktohen me short. FHK-ja dhe klubet kanë marrë masat për ta ruajtur shëndetin në rrethanat e reja në të cilat do të zhvillohen ndeshjet.

SHKURT

Presidenti i FShF-së: Derbi Partizani - Tirana mund të luhet me tifozë

Deri i kryeqytetit mes Partizanit dhe Tiranës mund të luhet me tifozë. Kjo është pohuar nga vetë presidenti i Federatës Shqiptare të Futbollit, Armand Duka. Ky i fundit në një prononcim për "Abc News", ka thënë se është e mundur që ndeshja e radhës mes dy ekipeve të kryeqytetit mund të luhet me tifozë. "Për ne është plotësisht e mundshme që derbi mes Partizanit dhe Tiranës të luhet me tifozë. Ne jemi dakord, por për këtë duhet të vendosin autoritetet shëndetësore. Duhet ta pyesni edhe kryeministrin Rama se çfarë mendimi ka", ka thënë Duka.

Tashmë duhet pritur për të parë nëse do të ketë një kërkesë që ndeshja e planifikuar më 12 korrik të zhvillohet nën praninë e tifozëve. Kjo do të bënte që "Air Albania" të rihapte stadiumin, i cili nuk është përdorur që më 8 mars, kur Tirana luante me Laçin.

Anulohet gara në Azerbajxhan, Japoni dhe Singapor

Formula 1 ka konfirmuar së fundmi se tri gara tejet interesante nuk do të kenë vend për kalendarin e këtij sezoni. Bëhet fjalë për Grand Prix Azerbajja, Japanese Grand Prix dhe Singapore Grand Prix. Gjithçka vjen si pasojë e pandemisë Covid-19, e cila bëri që kalendari dhe oraret e garave të tollovitën. Formula 1 ka besimin se do të ketë 15 deri në 18 gara, deri në kohën kur sezoni merr fund në Abu Dhabi, në dhjetor. Një kalendar i ri për sezonin 2020 në F1 pritet të publikohet para se sezoni të fillojë në Austri.

Eto'o: Mesi duhet të luajë deri në moshën 70-vjeçare

Ish-sulmuesi i Barcelonës, Samuel Eto'o, ka thënë se shoku i dikurshëm i skuadrës, Leo Messi, duhet të luajë futboll deri në moshën 70-vjeçare. Eto'o është i mendimit se Messi është lojtari më i mirë në botë dhe çdo ekip në botë do ta dëshironte në radhët e veta. "Është normale. Leo është lojtari më i mirë në botë dhe më i miri i të gjitha kohëve. Unë gjithmonë do ta pyesja Messin se cilin dëshiron ta ketë në krah, në ekipin e vet. Të gjitha skuadrat në botë duan një Messi. Ai nuk mund të vrapojë më si një 25-vjeçar. Ne, katalanët, duhet t'i japim atij ekipin më të mirë në botë, në mënyrë që ai të vazhdojë të na bëjë ta shijojmë futbollin. Më vjen keq për të, por kurrë nuk do ta lëmë të shkojë ose të pushojë. Ai duhet të luajë deri në moshën 70-vjeçare që ta shijojmë më gjatë", ka thënë Eto'o.

Van Dijk refuzon superofertën e PSG-së

Mbrojtësi Virgil Van Dijk nuk do të largohet nga Liverpooli. "The Sun" raporton se qendërmbrojtësi holandez ka gjetur gjuhën e përbashkët me drejtuesit e "The Reds" për zgjatjen e bashkëpunimit. Ish-futbollisti i Southamptonit duhet ta firmosë kontratën e re me kohëzgjatje për 5 vjet, në bazë të së cilës do të përfitojë 13 milionë euro në sezon, duke lënë pas edhe pagën aktuale të egjiptianit Salah (11.5 milionë). Tabloidi anglez shton se PSG-ja i kishte bërë një ofertë edhe më të rëndësishme Van Dijkut, që shkonte rreth 16 milionë euro në vit, por që nuk e ka bindur gjigantin e "tulipanëve" të transferohet në Paris. Zyrtarizimi i kontratës së re me Liverpoolin do të ndodhë në fund të kampionatit. Tani drejtuesit e kampionëve në pritje të Anglisë do të jenë të përqendruar në bisedimet për zgjatjen e kontratës së Manes.


Ministri i Sportit në Turqi: Finalja e Ligës së Kampionëve luhet në Stamboll

Stambolli nuk ka hequr dorë nga dëshira për ta zhvilluar finalen e Ligës së Kampionëve të këtij edicioni dhe këtë e ka konfirmuar ministri i Sporteve i Turqisë, Mehmet Kasapoglu, në një kohë që UEFA kishte nisur të shikonte opsione të tjera për selinë e veprimtarisë pas emergjencës së koronavirusit. Finalja ishte parashikuar fillimisht të luhej më 30 maj në stadiumin olimpiq "Ataturk" të Stambollit dhe qeveria e futbollit evropian do të vendosë për-

fundimisht për selinë që do të mirëpresë eventin më të rëndësishëm në mbledhjen e Komitetit Ekzekutiv më 17 dhe 18 qershor. Prej ditësh qarkullojnë emrat e Lisbonës, Frankfurtit apo Madridit si seli të mundshme. "Nuk kam asnjë dyshim që finalja do të zhvillohet në Turqi dhe në mënyrën më të mirë të mundshme. Ne jemi të bindur se më 17 qershor do të marrim lajme të mira", ka thënë Kasapoglu për televizionin "TRT Sport".



Autor: GAZMEND MORINA	KËNGËTARJA ITALIANE NË FOTO	NJËSI E MADHE USHT-ARAKE (shq.)	KËNGËTARE E NJOHUR AMERIKANE (shqip.)	TEPELENA, APOLONIA	AKUZUES I SOKRATIT	BASHKËT.	EPOKA E RE	SULEJMAN (perkdh.)	PËRKULJA NË NJËRËN ANË	BASHKËT.	LLOJ MOTOÇIKLETE (shq.)				
	DEGË E NJOMË, E GJATË DHE E HOLLË; FILIZ						NJË PLANET SHKENCA QË STUDIOU BIMËT								
	BASKETBOLLISTI MALIQI						SEKRETARI I OKB-së ... KI MUN KURESHTJA			BASHKËT. PËRMBLEDHJE E SISTEMUAR E NORMAVE JURIDIKE (shq.)					
	AKTORJA HOLIVUDIANE THURMAN				SHALQI (shq.) NJË E PANJOHUR NË MATEMATIKË										
	GJË E RRALLË E ME VLERË (Lat.)							KOHË LLOJ GJELLE VETËM ME ORIZ (shq.)							
	MËSYMJE					E VRULLSHME, E RRËMBYESHME TANTAL									
	MINUS (mat.)				KASOLLJA E BARINJVE NOTË MUZIKORE				INA RAMA KAMPIONI, ASI (Sport)						
ZANORE		BASHKËT. "RISANI"		AI QË E KISHTE DOBËSI THEMBRËN AJKA E QUMËSHTIT					ZANORE PRIJËS I HUNËVE						
EPOKA E RE	LLOJ BIME NARKOTIKE	SHKRIMTARJA MAMAQI	PUSHIM GJATË VERËS	ERË E KËNDSHME	LETRARI PETRO ... LUARASI	PËRGËZIM OLIVIA MUNN					EMRI I KOMANDANT KUMANOVA (UÇK)				
ENË QELQI E RRUMBULLAKËT SI SHISHE, PO ME GRYKË TË GJERË E ME KAPAK											AFET BELA DIÇKA E MËRZITSHME NGAQË PËRSËRITET GJITHNJË	KOHA BRENDË SË CILËS DUHET TË KRYHET NJË VEPRIM NAPA, RUBA			
ANËTARËSIMI NË NJË ORGANIZATË											KIK-BOKSIERI MAKSUTAJ KASOLLE PËR GJËNË E GJALLË	REGJISORJA ... ELEZI TEDI ALVES			
PERANDOR ROMAK KËNGËTARI ... ARIFI (shq.)						ANIJATAT						INSTITUTE LEADERSHIP MANAGEMENT ZYRTARIZIMI I NJË TRAKTATI			
▶						I KAPËRDIJ KUVENDI POPULLOR I ATHINASVE TË LASHTË						KOHË E NDARË PËR PUNË E QESHURA TALLËSE	DY ZANORE LLOJ GJELLE ME PATATE		
KULTURË BUJQËSORE E ARAVE						ZANORE AKTORI EGJIPTIAN ... SHARIF						FABRIKA E MEKANIZUAR URAN, NATRIUM	ARMENIA POLONIA I NDESH	BASHKËT. KËNGËTARJA BUNJAKU	
"INDANA"			LAKESAT									KUFIZIM AI QË THER BAGËTI (pashq.)		SEKT I VEÇANTË I MYSLIMANËVE (shq.)	
FUTBOLLISTI KALOU												DEM	AMSHIM, PËRJETËSI BASHKËT.		
EPOKA E RE	QYTET I SHENJTË I MYSLIMANËVE	LLOJ PAPA-GALLI ZAKONET										TË BUKURIT TRAJNERI ANGLEZ ... BRUCE (shqip.)	SKANDALI I BIE DERËS		
MEKANIZËM PËR TË LEHTËSUAR NGRITJEN E PESHAVE TË RËNDA												"I" pas dy "S" RRRITJA E SASISË	TON, SILIC OHAJO	"IRLANDA" ZANORE	
ALBANOLOGIA DURHAM						POLITIKANI SHQIPTAR ... NDOKA	MUAJ I VITIT							SECILA NGA PJESET E NJË NDËRTESE BREJTËS I VOGËL	
QENIE MBINJERËZORE ME FUQI TË FSHEHTË (mt.)							LLOJE, SOJE RAST							NJËSIA E REZISTENCËS ELEKTRIKE LETËR E FORTË NË BIXHOZ	ANITA KOSUMI KËNGËTARJA ... FARA
PËRSËRITËS (gram.)														NDESHJA (sh.pashq.) KAM DIJENI PËR DIÇKA	ZANORE ERMELINDA MEKSI
RRJETË E TENISIT														PJESË E MUAJIT BASHKËT.	EPILEPSI ZANORE
AGIM TEJECI														SHBA (ang. orgj.)	PËREMËR PRONOR


 Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria - Vlada-Government
 Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës
 Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik - Shtime
 The Centre for integration and rehabilitation of chronic psychiatric patients - Shtime
 Centar za integrisanje i rehabilitaciju hroničnih psihijatrijskih bolesnika - Štimlje
 Sektor i Personelit

Në bazë të nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212; nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) nr. 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik; nenit 6 paragrafi 1.1, nenit 10 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinikë Universitar i Kosovës (SHSKUK); nenit 62 paragrafi 6 të Ligjit Nr. 04/L-125, për Shëndetësi; kërkesës nr.262 si dhe aprovimit të kërkesës me Nr 262 nga Drejtoria i përgjithshëm i SHSKUK-se; Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik Psikiatrik - Shtime, publikon:

KONKURS PUBLIK

I. Institucioni: Qendra për Integrimin dhe Rehabilitimin e të Sëmurëve Kronik dhe Psikiatrik-Shtime

Pozita punës: Ndhmës mjekësor (dy pozita)

Koeficienti i pagës: 5

Orari i punës: 1 plotë

Kohëzgjatja e kontratës: Kohë të pacaktuar

Nr. i Referencës: QIRSKP- 01/2020

Qëllimi kryesor i vendit të punës:
Ofrimi i shërbimeve shëndetësore duke u bazuar në nivelin profesional që kërkohet për të gjithë profesionistët shëndetësor.

Përshkrimi i punëve dhe fushat e përgjegjësisë për ndihmës mjekësor :

- Përgatitja e pacientëve për mëngjes me nivel të lartë të higjienës personale
- Qëndrimi në kuzhinë në mëngjes, drek dhe darkë deri sa ushqehen klientët
- Dërgimi i ushqimit me tase në repart për klientët që nuk ushqehen në kuzhinë (pasi të ketë mbaruar ushqimi për klientët tjerë që ushqehen në kuzhinë)
- Higjiena personale, pastrimi i klientëve, kujdesi për veshmbathjen, rregullimi i depos së veshmat, jeve
- Dërgimi dhe marrja e rrobave nga rrobalarje
- Për çdo ndryshim të gjendjes shëndetësore të klientit, lajmërohet infermieri i repartit
- Përgatitja e klientëve për gjumë natë (pastrimi i këmbëve- higjiena personale në nivel)
- Gjate gjithë ndërrimit të natës pacientet duhet të jene nën mbikqyerje të vazhdueshme të ndihmës mjekësor
- Për të gjitha punët dhe shërbimet e kryera ndihmësi mjekësor obligohet të mbaj shënime në fletore të raportit të kujdestareve.
- Ndhimesat mjekësor raportojnë te infermierët
- Të kryejë edhe detyra tjera që kërkohen nga mbikëqyrësi për të siguruar efikasitet të lartë në punë.

I. Dokumentet e kërkuara – fotokopje :

- Diploma e Shkollës së Mesme
- Dëshmi se nuk është nën hetime
- Certifikata nga libri amzë i të lindurve,
- Letërnjoftimi – fotokopje,
- Njohja e kompjuterit (Word dhe Exel) – e dëshirueshme,
- Mund të sillni edhe dëshmi tjera të aftësisë profesionale.

Dokumentacioni i bashkangjitur këtij aplikimi nuk kthehet.
Origjinalin e këtyre dokumenteve ose të vërtetuara të noteri do të kërkohet vetëm atëherë kur kandidati thirret për punë.
- Përvoja e punës do të ketë përparësi.

Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim:

-Të drejtë aplikimi kanë të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, kanë mbaruar shkollimin e kërkuar dhe kanë aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave sipas këtij konkursi.


Procedurat e konkurrimit: Konkurrimi është hapur për të gjithë kandidatët e interesuar. Konkursi është i shpallur 15 ditë nga dita e publikimit në mjetet e informimit


Në testim do të ftohen vetëm kandidatët që kanë plotësuar kriteret e konkursit. Kandidatët që i plotësojnë kriteret e konkursit do t'i nënshtrohen testit me shkrim, dhe të gjithë kandidatët të cilët nuk e kalojnë testin me shkrim mbi 50% do të diskualifikohen automatikisht. Ndërsa të gjithë kandidatët që ju kanë nënshtuar testit me shkrim, dhe kanë arritur të kalojnë atë 50% e më shumë të pikëve të tij, do të ftohen në intervistën me gojë, pranë komisionit përzgjedhës. Renditja e kandidatëve do të bëhet sipas pikëve të përgjithshme që do të fitoj çdo kandidatë nga dy proceset si më sipër (testimi me shkrim dhe intervista me gojë).

Paraqitja e kërkesave: Aplikacionet merren dhe dorëzohen në zyrën e Sektorit të Personelit në QIRSKP-Shtime. Në aplikacion duhet të ceket qartë titulli i vendit të punës dhe numri i referencës.

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do të pranohen.

Shtime, dt.12.06.2020

Drejtoria e QIRSKP-Shtime

 Dr.Miftar Zenelaj


 REPUBLIKA E KOSOVËS
 REPUBLIC OF KOSOVO
 KOMUNA E SUHAREKËS - MUNICIPALITY OF SUHAREKA

11.06.2020
 MARRË NË DORËZIM PRIMLJENJE - RECEIVED

Nënoja org. Org. Jedinica Org. Unit	Numri Broj Number	Shtojca Prilog Appendix	Vlera Vrednost Value
11	104	22251	2

11 Nr.	Komisioni për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluejtshme të Komunës	Datë: 11.06.2020
--------	--	------------------

Në bazë të vendimit 01-Nr-016-18207 të datës 21.05.2020 të Asamblesë Komunale, në bazë të Vendimit për formimin e komisionit 01-Nr-016-41940 të datës 28.06.2019, në bazë të procesverbalit nr.41/2020 të komisionit për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluejtshme të komunës të datës 11.06.2020 komisioni përkatës shpallë:

KONKURIM TË HAPUR
Nr.03/2020

Për dhënie në shfrytëzim afatgjatë deri 99 (nëntëdhjetë e nëntë) vite të pronës komunale :

1.1 Banesa, e cila gjendet në rrugën “Brigada 123” në Suharekë, **Biloku “C”** shifra 19, Nr.23, sipas sistemit të unifikuar të adresave , kati VI me sipërfaqe të përgjithshme prej S=64.66m², pasuri shoqërore në emër të Komuna e Suharekës.

1.2 Banesa, e cila gjendet në rrugën “Brigada 123” në Suharekë, **Biloku “B2”** shifra 12, Nr.26, sipas sistemit të unifikuar të adresave , kati VI me sipërfaqe të përgjithshme prej S=61.70m², pasuri shoqërore në emër të Komuna e Suharekës.

1.3 Banesa, e cila gjendet në rrugën “Brigada 123” në Suharekë, **Biloku “B2”** shifra 12, Nr.31, sipas sistemit të unifikuar të adresave , kati VII me sipërfaqe të përgjithshme prej S=61.70m², pasuri shoqërore në emër të Komuna e Suharekës.

Dëshmitë e kërkuara:

1. Kopja e dokumentit të identifikimit.
2. Deklaratë e bashkësisë familjare, lëshuar nga sektori i gjendjes civile.
3. Dëshmi që ofertuesi është anëtar i familjes së dëshmorit.
4. Dëshmi për kryerjen e obligimeve komunale, lëshuar nga Drejtoria për Ekonomi, Buxhet dhe Financa.

Kriteret e kërkuara:

- Oferta e kompletuar me dokumentet e kërkuara .
- Të respektohet lista e pritjes me numër 01-16-1663 me datë 29.10.2010.
- Çmimi fillestar për njësi banesore 5€/muaj

Vërejtje:

- Aplikimi me mungesë të ndonjërit prej dokumenteve do të thotë diskualifikim.
- Aplikuesi ka të drejtë të tërhiqet nga aplikimi i hapur jo më vonë se 3 (tre) ditë nga hapja e ofertave.
- Familjet të cilat kanë përfutur parcelë, banesë, shtëpi apo përfitime të ngajshme për sigurim të banimit nga Komuna nuk kanë të drejtë konkurimi.
- Aplikuesi mund të jetë përfitues i vetëm një banesore.


Afati për tërheqjen e formularit të ofertave është deri më date 26.06.2020 zyra e Prokurimit nr.12-kati 3, Komuna Suharekë.

Afati i dorëzimit të ofertave deri më date 29.06.2020 deri në ora 13:30 zyra pritëse nr.1 Komuna Suharekë.

Hapja e ofertave bëhet më 29.06.2020 në ora 14:00 në sallën e bordit në Komunën e Suharekës.

Hapjen dhe vlerësimin e ofertave e bën komisioni përkatës nga Kuvendi Komunal i Suharekës dhe përfituesin e vendos Asambleja Komunale konform ligjit Ligji NR. 06/L-092.

Për informata shtesë:
Nr. tel: 029/271-708
emrush.bytyci@rks-gov.net

Kryesuesi i komisionit
 Emrush BYTYCI




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Skenderajt
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim / Department of Education

Nr.1538/2020
Dt. 12.06.2020

Duke u bazuar në Nenin 62, Paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L -040 për Vetëqeverisjen Lokale, bazuar në Nenin 53 par. 3 të Statutit të Komunës së Skenderajt dhe bazuar në Rregulloren për ndarjen e subvencioneve nr 1/110-33792 të datës 16.06.2015 e miratuar nga Kuvendi Komunal - Skenderaj, Drejtoria për Arsim, shpall:

KONKURS PËR NDARJEN E BURSAVE

PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË SKENDERAJT

Komuna e Skenderajt ndanë 170 bursa për studentët e kësaj komune, që studiojnë në universitetet publike të Kosovës në vitin akademik 2019-2020, në të gjitha fakultetet apo drejtimet e studimit (megjithëse vetëm studentët e disa fakulteteve marrin pikë bonus, të gjithë studentët kanë mundësi të përfitojnë bursa). Vetëm studentët e rregullt të nivelit Bachelor kanë të drejtë konkurrimi për përfitimim e bursës komunale.

Vlera e bursës komunale për një student është 300 euro.

Për studentët, që janë në vitin e parë të studimeve do të ndahen 50 bursa, ndërsa bursat tjera do të ndahen për studentët që janë në vitin e dytë, vitin e tretë dhe në vitin e katërt të studimeve bachelor.

Kushtet për konkurrim për bursë komunale

Kandidati duhet:

1. Të jetë banor i Komunës së Skenderajt;
2. Të jetë student i rregullt në vitin akademik 2019-2020, në ndonjërin nga universitetet publike të Kosovës;
3. Të jetë student i nivelit Bachelor;
4. Të mos e ketë përsëritur (humbur) vitin akademik;
5. Të mos jetë në marrëdhënie pune me pagesë, me orar të plotë;
6. Të mos jetë përfytyes i bursave tjera për vitin akademik shkollor 2019/20;

Kriteret për përzgjedhjen e përfytyesve të bursave komunale

Përzgjedhja e përfytyesve të bursave komunale bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat, bazuar në kriteret e specifikuar në tabelën e mëposhtme. Nëse një kandidat i plotëson më shumë se një nga kriteret/kategoritë e mëposhtme, atëherë mbledhet totali i pikëve të fituara nga secila kategori (përveç pikëve për notë mesatare, të cilat i fiton varësisht prej notës mesatare që ka kandidati). Nëse kandidatët mbesin me pikë të barabarta, atëherë vendoset duke i dhënë përparësi kategorive, ashtu siç janë të renditura në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Kriteri/Kategoria	Pikët
	Nota mesatare në studime 10.00	100
	Nota mesatare 09.50 – 9.99	95
	Nota mesatare 9.00 - 9.49	90
1	Nota mesatare 8.50 - 8.99	85
	Nota mesatare 8.00 - 8.49	80
	Nota mesatare 7.50 - 7.99	75
	Nota mesatare 7.00 - 7.49	70
	Nota mesatare 6.50 - 6.99	60
	Nota mesatare 6.00 - 6.49	50
2	Student nga familja me ndihmë sociale	40
3	Fëmijë me nevoja të veçanta	30
4	Student bonjak (pa të dy prindërit)	20
5	Student – fëmijë i dëshmorit të UÇK-së	20
6	Student – fëmijë i invalidit të luftës së UÇK-së	10
7	Student – fëmijë i veteranit të luftës së UÇK-së	10
8	Student i gjinisë femërore	5
9	Student, që studion më shumë se një drejtim studimi - mund të jetë edhe në nivel tjetër të studimeve (Doktoratë) përveç studimeve Bachelor ose Master	5
10	Student që ka edhe ndonjë anëtar tjetër të familjes së ngushtë në studime (motër, vëlla, prind, fëmijë). Anëtarit tjetër mund të jetë edhe në nivel tjetër të studimeve (Master ose Doktoratë)	5
11	Student në Fakultetin e Mjekësisë	5
12	Student në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike	5
13	Student në Fakultetin e Shkencave Matematiko - Natyrore	5
14	Student në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë	5
15	Student në Fakultetin e Edukimit	5
16	Student në Fakultetin e Gjeoshkencave, Xehetarisë dhe Metalurgjisë	5
17	Student në Fakultetin e Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës	5
18	Student në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike	5

Të gjitha statuset e kategorive të përfshira në tabelën e mësipërme duhet të dëshmojnë me dokumente valide të lëshuara nga institucionet relevante, siç përshkruhet më poshtë.

Aplikacioni i kompletuar duhet të ketë këto dokumente:

Të gjithë kandidatët duhet të dorëzojnë:

- Formularin e aplikimit të plotësuar (merret në katin e parë, sporteli nr.13) ose shkarkohet nga faqja e komunës;

- Dokumentin personal (letërnjoftimin ose pasaportën);
- Ekstraktin e lindjes ose Certifikatën e lindjes;
- Kartelën Identifikuese të studentit;
- Vërtetimin nga universiteti publik (fakulteti apo departamenti përkatës) se, kandidati është student i rregullt në vitin përkatës të studimeve, duke specifikuar fakultetin/drejtimin e studimeve, që kandidati e ka të regjistruar vitin akademik 2019 - 2020 dhe që kandidati nuk ka përsëritur (humbur) ndonjë vit akademik;
- Certifikatën e notave të studimeve;
- Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) se, kandidati nuk ka marrëdhënie të rregullt pune.

Kandidatët që i plotësojnë kriteret e sipërpërshkruara në tabelë duhet të dorëzojnë:

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 1 - dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës dhe certifikatën e notave;

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 2 - dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 3 - dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës;

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 4 - certifikatat e vdekjes së të dy prindërve;

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 5 - dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës dhe

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 6 - dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës;

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 7 - dëshminë zyrtare nga institucioni përkatës dhe certifikatën familjare;

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 9 - dëshminë zyrtare nga universiteti publik;

Kandidatët që e plotësojnë kriterin nr. 10 - dëshminë zyrtare nga universiteti publik për anëtarin e familjes dhe certifikatën familjare.

Sqarime shtesë

Të gjitha dokumentet që dorëzohen me rastin e aplikimit duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen për t'u konfirmuar të dhënat vetëm për kandidatët që përzgjedhen si përfytyes të bursave.

Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim.

Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente përkatëse (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Afati dhe mënyra e aplikimit

Konkursi është i hapur prej datës 13.06.2020 deri më 29.06.2020. Aplikacionet pranohen çdo ditë pune prej orës 09:00 - 15:00. Përfytyesit e bursave do të informohen pas përzgjedhjes finale dhe do të publikohen në webfaqe të komunës së Skenderajt.

Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuar) duhet të dorëzohet në komunë, në sportelin nr.13 përmes protokollit, në objektin e Komunës së Skenderajt.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Skenderajt
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Drejtoria për Arsim / Department of Education

Nr.1538/2020
Dt. 12.06.2020

Duke u bazuar në Nenin 62, Paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L -040 për Vetëqeverisjen Lokale, bazuar në Nenin 53 par. 3 të Statutit të Komunës së Skenderajt dhe bazuar në Rregulloren për ndarjen e subvencioneve nr 1/110-33792 të datës 16.06.2015 e miratuar nga Kuvendi Komunal - Skenderaj, Drejtoria për Arsim, shpall:

KONKURS PËR NDARJEN E BURSAVE

PËR STUDENTË TË KOMUNËS SË SKENDERAJT

Komuna e Skenderajt ndanë 170 bursa për studentët e kësaj komune, që studiojnë në universitetet publike të Kosovës në vitin akademik 2019-2020, në të gjitha fakultetet apo drejtimet e studimit (megjithëse vetëm studentët e disa fakulteteve marrin pikë bonus, të gjithë studentët kanë mundësi të përfitojnë bursa). Vetëm studentët e rregullt të nivelit Bachelor kanë të drejtë konkurrimi për përfitimim e bursës komunale.

Vlera e bursës komunale për një student është 300 euro.

Për studentët, që janë në vitin e parë të studimeve do të ndahen 50 bursa, ndërsa bursat tjera do të ndahen për studentët që janë në vitin e dytë, vitin e tretë dhe në vitin e katërt të studimeve bachelor.

Kushtet për konkurrim për bursë komunale

Kandidati duhet:

1. Të jetë banor i Komunës së Skenderajt;
2. Të jetë student i rregullt në vitin akademik 2019-2020, në ndonjërin nga universitetet publike të Kosovës;
3. Të jetë student i nivelit Bachelor;
4. Të mos e ketë përsëritur (humbur) vitin akademik;
5. Të mos jetë në marrëdhënie pune me pagesë, me orar të plotë;
6. Të mos jetë përfytyes i bursave tjera për vitin akademik shkollor 2019/20;

Kriteret për përzgjedhjen e përfytyesve të bursave komunale

Përzgjedhja e përfytyesve të bursave komunale bëhet në bazë të numrit më të madh të pikëve totale që merr një kandidat, bazuar në kriteret e specifikuar në tabelën e mëposhtme. Nëse një kandidat i plotëson më shumë se një nga kriteret/kategoritë e mëposhtme, atëherë mbledhet totali i pikëve të fituara nga secila kategori (përveç pikëve për notë mesatare, të cilat i fiton varësisht prej notës mesatare që ka kandidati). Nëse kandidatët mbesin me pikë të barabarta, atëherë vendoset duke i dhënë përparësi kategorive, ashtu siç janë të renditura në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Kriteri/Kategoria	Pikët
	Nota mesatare në studime 10.00	100
	Nota mesatare 09.50 – 9.99	95
	Nota mesatare 9.00 - 9.49	90

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Dhf Company" Sh.p.k Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Depon e karburanteve, naftë, benzin, mazut, GLN, grumbullimin dhe magazinimin e vajit motorik mbeturinë, vajit ushqimor mbeturinë në Bellopojë, Pejë.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 09.07.2020 në ora 11:00 në Hotelin King që gjindet në segmentin rrugore Pejë - Deqan në anën e majte të këtij segmenti rrugor do të organizohet debat publik nga kompania "Dhf Company" Sh.p.k Pejë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Depon e karburanteve, naftë, benzin, mazut, GLN, grumbullimin dhe magazinimin e vajit motorik mbeturinë, vajit ushqimor mbeturinë në Bellopojë, Pejë.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Marbleks" Sh.p.k Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatimin e gurit dekorativ në Rahovec.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 07.07.2020 në ora 11:00 në objektet e kompanisë "Green Power" sh.p.k. në fshatin Zatriq, KK Rahovec. do të organizohet debat publik nga kompania "Marbleks" Sh.p.k Mitrovicë, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Objekti është në afersi nga vendburimi dhe gjindet në anën e djathtë të rrugës për fshatin Zatriq 3 km nga magjistralja Malisheve-Rahovec. Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për eksploatimin e gurit dekorativ në Rahovec.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-214 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis, Neni 20, pika 2 dhe 4, Kompania "Granit" Sh.p.k Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit, organizojnë:

DEBAT PUBLIK

Për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për eksploatimin e gurit gëlqeror në Lubozhdë, Istog.

Njoftohet publiku i interesuar se më datën 08.07.2020 në ora 11:00 në Restoran FRESKIA në Istog, rruga Burimi nr. 111, 31000 Istog do të organizohet debat publik nga kompania "Granit" Sh.p.k Istog, në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit.

Debati publik do të organizohet për Raportin e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për Pëlqim Mjedisor, për eksploatimin e gurit gëlqeror në Lubozhdë, Istog.

Pjesëmarrja e juaj na ndihmon në implementimin e projektit.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- ▶ "Endriti Commerce" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr. 71111504.
- ▶ Jahi Murtezani shpall të pavlefshme numrin e Certifikatës së biznesit 601189071 D.P.Z "Ferguson - te Celi" Hani Elezit
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardani. Banesa është 50 m2, e mobiluar në tersi dhe është e gatshme për banim. Banesa preferohet për qift familjar. Tel: 044-171-328.
- ▶ Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon. Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- ▶ Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- ▶ Lëshoj banesë me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Fejza", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Fejza" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- ▶ Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.
- ▶ Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- ▶ Urgjentisht kërkohet një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- ▶ Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- ▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

